



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit / Ured Premiera / Office of Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance



Platforma kombëtare për mbrojtje
nga diskriminimi për komunitetet
Rom, Ashkali dhe Egjiptian

RAPORT

PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE
NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM,
ASHKALI DHE EGJIPTIAN, DHE ROLI I SAJ NË
LUFTIMIN E DISKRIMINIMIT

(2022–2025)

Prishtinë, Prill 2026

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	4
Mesazh hyrës	5
1. Hyrje.....	7
2. Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me diskriminimin.....	9
2.1. Raportimi i rasteve të diskriminimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Platformë - viti 2025 shënon rritje të besimit dhe efikasitetit në zgjidhjen e rasteve	10
3. Mekanizmat institucionalë të mbrojtjes nga diskriminimi sipas LMD-së dhe Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi të Komuniteteve rom, ashkali si mekanizëm mbështetës.....	13
3.1. Grupi Teknik për mbrojtje nga diskriminimi për komunitet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës.....	14
4. Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe rastet e raportuara nga qershori 2022 deri më 31 dhjetor 2025	17
4.1. Rastet e adresuara nga Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian - Përshkrim i shkurtër i adresimit dhe veprimeve të ndërmarra në të gjitha rastet.....	19
4.2. Viti 2025, vit i parandalimit të diskriminimit përmes rasteve të raportuara në Platformë, si dhe sfidat e identifikuara	32
5. Të drejtat që i janë shkelur komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes rasteve të raportuara në platformë	34
6. Ndikimi i Platformës Kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në luftimin e diskriminimet	36
7. Promovimi i Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	39
8. Funksionimi i mekanizmave për mbrojtjen dhe luftimin e diskriminimit përmes Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian/Viti 2025 - vit i parandalimit të diskriminimit.....	42
9. Rastet e trajtuara nga institucionet - Storie suksesi për vitin 2025	45
9.1. Rasti i sulmit dhe diskriminimit, shoqëruar edhe me vepër penale, si dhe reagimi i shpejtë i prokurorit të shtetit	45
9.2. Rasti i diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në arsim, i parandaluar me sukses.....	45
9.3. Rasti i diskriminimit në sektorin shëndetësor privat - rast që tregon vetëdijesim të sektorit privat ndaj diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian	45
10. Përfundimet dhe rekomandimet	47
SHTOJCA I: PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN, PARAQITUR NË STATISTIKA.....	51
SHTOJCA II: PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN, PARAQITUR NË STATISTIKA PËR VITIN 2025	56





SHKURTESAT

1. ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
2. ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës;
3. Grupi Teknik	Grupi Teknik i punës për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës;
4. HEKS/EPER	Hilfswerk Der Evangelischen Kirchen Der Schweiz;
5. IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit;
6. IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës;
7. KEC	Qendra e Kosovës për Arsim;
8. KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj;
9. KFOR	NATO Kosovo Force;
10. KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
11. KKP	Këshilli Konsultativ për Komunitete;
12. KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës;
13. Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008;
14. LMD	Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Nr. 05/L -021
15. MPB	Ministria për Punë të Brendshme;
16. MSH	Ministria e Shëndetësisë;
17. Platforma	Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
18. Swiss Cooperation Agency	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim;
19. TdhK	Terre des hommes Laussane në Kosovë;
20. VoRAE	Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve;
21. ZQM/ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit - Republika e Kosovës.





MESAZH HYRËS

Z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim



“Raporto Padrejtësinë. Ndërto Barazinë.”

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim pranë Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) përbën njërin nga mekanizmat kyçë dhe më të rëndësishëm brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës. Mandati i saj buron nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në veçanti nga neni 10 i këtij ligji, i cili përcakton rolin dhe përgjegjësitë e saj institucionale. Roli kryesor i ZQM/ZKM qëndron në hartimin dhe zhvillimin e politikave kundër diskriminimit, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe në përf forcimin e mekanizmave institucionale për mbrojtje nga diskriminimi, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal.

Në funksion të përmbushjes sa më efektive të këtij mandati, është themeluar edhe Grupi Teknik për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si mekanizëm mbështetës për adresimin e çështjeve specifike që prekin këto komunitete.

ZQM/ZKM ka vijuar me përkushtim punën e saj në luftimin dhe parandalimin e diskriminimit, veçanërisht ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për këto komunitete. Kjo platformë përfaqëson njërin nga arritjet më të rëndësishme në adresimin e diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve, si dhe ka shërbyer si mekanizëm plotësues, duke mbështetur institucionet e mandatuara sipas Ligjit në fuqi për Mbrojtjen nga Diskriminimi në ushtrimin e përgjegjësiave të tyre.

Puna e vazhdueshme dhe rezultatet e arritura në kuadër të platformës janë fryt i bashkëpunimit të ngushtë midis stafit të ZQM/ZKM, ekipit profesional të angazhuar, si dhe partnerëve mbështetës, konkretisht projektit “Drejtësia Sociale për romë, ashkalinj dhe egjiptianë në Kosovë”, i cili zbatohet nga Terre des hommes Lausanne në Kosovë (TdHK), në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER). Megjithatë, puna jonë nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen dhe besimin e vetë pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo punë e përbashkët ka rezultuar edhe me një numër të rasteve të raportuara dhe të adresuara, përgjatë këtyre viteve, përfshirë edhe vitin e fundit 2025, ku janë raportuar 17 raste.



Përgjatë këtyre viteve (2022-2025), Platformën e kanë karakterizuar shumë suksese, ndër të cilat edhe trajtimi i dy (2) rasteve, me aktgjykim të Gjykatës kompetente. Duhet përmendur se deri në vitin 2024, në Platformë ishin trajtuar me sukses 17 raste, kurse në anën tjetër vetëm në vitin 2025, numri i rasteve të adresuara me sukses ishte 16 raste, që shfaq një rritje të dukshme të suksesit të platformës në parandalimin e diskriminimit, në rastet e adresuara. Nga numri i rasteve të zgjidhura në vitin 2025, mund të thuhet se këtë vit Platforma ka pasur rol parandalues, për shkak se shumica e rasteve të zgjidhura kanë arritur të parandalojnë diskriminimin.

Përgjatë gjithë viteve dhe deri tani, numri i vizitorëve në Platformë ka qenë mbi 20 mijë (23,431), ndërsa ka mbi 800 llogari aktive të përdoruesve, duke treguar shtrirjen e madhe tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo tregon se Platforma tani është kthyer në një mekanizëm shumë të rëndësishëm të luftimit të diskriminimit, që po përfiton në besim çdo ditë e më shumë.



Puna dhe sukcesi i vazhdueshëm asnjëherë nuk janë të mjaftueshme. Për të luftuar diskriminimin, duhet të mos heshtet – secili rast i diskriminimit duhet të raportohet në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi! Raportoni në: www.raportodiskriminimin.org.

Me besim të plotë, u bëj thirrje të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që përjetojnë diskriminim, ose janë në dijeni për raste të tilla, që ta përdorin platformën. Bashkë, mund të raportojmë padrejtësinë dhe të ndërtojmë barazinë.



1. HYRJJE

Duke u bazuar në qëllimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Nr. 05/L-021 (LMD), zbatimi efikas i LMD-së është i rëndësishëm për të luftuar diskriminimin mbi baza etnike.

Ky Raport është hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, duke marrë shkas nga LMD (Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi), ku neni 10 përcakton detyrimin e ZQM/ZKM-së që të parashtrijë raporte mbi zbatimin e LMD-së, me qëllim të luftimit të diskriminimit.¹

Me qëllim të luftimit të diskriminimit, e për të përmbushur qëllimin e LMD-së, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit ka marrë nismën, si dhe me mbështetje të partnerëve, ka zhvilluar Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ky raport ka për qëllim që të pasqyrojë gjendjen e diskriminimit të komuniteteve përkatëse, përmes rasteve të raportuara në platformë, të cilat janë adresuar nga ekipi profesional i platformës dhe institucionet kompetente sipas LMD-së. Po ashtu, raporti ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të luftimit të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes rasteve të raportuara në platformë.

Përveç raporteve të përgjithshme për zbatimin e LMD-së, në këtë rast së bashku me partnerët mbështetur nga projekti “Drejtesia Sociale për Romë, Ashkalinj e Egjiptianë në Kosovë” që zbatohet nga Terre des hommes Laussane në Kosovë (TdhK), në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER), e që financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (Swiss Cooperation Agency), Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit ka hartuar këtë raport për të pasqyruar zbatimin e LMD-së, në veçanti përkitazi me mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ky raport, përveç raporteve të përgjithshme për zbatimin e LMD-së, është bazuar edhe në rastet e raportuara në Platformë.

Në këtë raport janë përfshirë të gjitha rastet e raportuara dhe të trajtuara nga platforma, që nga fillimi i punës së saj e deri në rastet e paraqitura deri më datë 31 Dhjetor 2025.



Raporti bazohet në një metodologji gjithëpërfshirëse, që pasqyron të dhëna për diskriminimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes platformës, si dhe masat që janë ndërmarrë nga institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit për komunitetet në fjalë. Metodologjia e këtij raporti përfshin:

- Analizën e të dhënave për diskriminimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Analizën e të dhënave për rastet e paraqitura në platformë, përfshirë edhe aspektin statistikor dhe trajtimin e tyre nga institucionet;
- Analizën e çështjeve të ngritura në lidhje me zbatimin e LMD-së, ndërlidhur me rastet e diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, etj.

¹ Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 10.7.



Në raport pasqyrohet puna e platformës për periudhën prej 3.5 vitesh, duke filluar nga **qershori i vitit 2022 deri më 31 dhjetor 2025**. Raporti po ashtu pasqyron analizën e rasteve të raportuara në platformë, së bashku me statistikat konkrete, përfshirë edhe rastet që janë trajtuar suksesshëm nga ana e kësaj platforme lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë edhe aspektin e shkeljes së të drejtave të caktuara kushtetuese, me bazë diskriminimin.

2. GJENDJA E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN LIDHUR ME DISKRIMINIMIN

Përveç rasteve të raportuara në platformë, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë raportuar ankesa dhe në institucionet tjera kompetente për zbatimin e LMD-së. Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2023 tregon se IAP ka pranuar 38 ankesa për këto komunitete dhe atë, 22 ankesa nga komuniteti ashkali, 19 ankesa nga komuniteti rom dhe 7 ankesa nga komuniteti egjiptian.² Avokati i Popullit, me 30 mars 2023, për të vërtetuar gjendjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ka vizituar lagjen "Adem Voca", e cila banohet nga këto komunitete në Mitrovicën e Jugut. Raporti i Avokatit të Popullit, ndër të tjera, lidhur me këtë vizitë ka theksuar: *"Pjesëmarrësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me mungesën e kushteve elementare për jetesë, gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale, nivelin e lartë të papunësisë, pretendimet për diskriminim nga organet komunale si dhe nga institucionet e tjera publike dhe private. Ndër problemet më shqetësuese dhe që kërkonte veprim urgjent të autoriteteve, qoftë atyre komunale por dhe të atyre qendrore, është prezenca e madhe e mbeturinave në rrugë por edhe brenda bodrumeve dhe hyrjeve të banesave kolektive, të cilat paraqesin rrezik serioz për banorët. Bartja e mbeturinave, sipas banorëve, nuk bëhet nga kompania e kontraktuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, për shkak që banorët e kanë të pamundur pagesën e faturave për shkaqe ekonomike"*.³ Raporti i progresit për Kosovën në vitin 2024, ndër të tjera, ka potencuar diskriminimin e grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në fushën e arsimit, punësimit dhe qasjes në shëndetësi. Martesat e hershme, veçanërisht për gratë e këtyre komuniteteve, konsiderohen dhe vlerësohen si një fenomen shqetësues.⁴ Raporti i progresit për Kosovën e cilëson si joefektiv Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, në luftimin e antigjipsizmit.⁵ Në anën tjetër, raporti i progresit për Kosovën i vitit 2024 thekson se gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të vuajnë nga forma të shumta të diskriminimit.⁶

Raporti i Avokatit të Popullit i vitit 2024 ka pasqyruar se numri i ankesave të hapura për hetim tek Avokati i Popullit për këto komunitete është: komuniteti rom 7, ai ashkali 5 dhe komuniteti egjiptian 5.⁷ Ndërkohë, i njëjti raport thekson se numri i ankesave për vitin 2024 për komunitetet është si në vijim: komuniteti rom 17, ashkali 23, egjiptian 10.⁸ Ndër të tjera, raporti vjetor i Avokatit të Popullit, i vitit 2024, lidhur me diskriminimin thekson: *"Diskriminimi etnik, i cili manifestohet në punësimin në sektorin publik, është një tjetër sfidë. Përfaqësimi i pamjaftueshëm i komuniteteve jo-shumicë, në veçanti romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët,*

² Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, për vitin 2023, f.16.

³ Po aty, f.64.

⁴ Bruksel, 30.10.2024 SWD(2024) 692 final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2024 Report, f.36.

⁵ Po aty, f.38.

⁶ Brussels, 4.11.2025 SWD(2025) 752 final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2025 Report, f.37.

⁷ Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, për vitin 2024 f.21.

⁸ Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, për vitin 2024 f.18.

vazhdon të jetë problematikë që duhet adresuar për të siguruar përfshirje të barabartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët”⁹

Lidhur me diskriminimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, raporti për të drejtat e njeriut i hartuar nga shoqëria civile ndër të tjera thekson: “Për dallim nga politikëbërja gjithëpërfshirëse, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë përballen me diskriminim në bazë të përkatësisë së tyre etnike, përkundër Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili parandalon diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Stigma që i është vënë kulturës së tyre i ka shtyrë ata më tej drejt marginalizimit, duke rezultuar në qasje të pabarabartë në kujdesin shëndetësor, punësim dhe arsim”¹⁰. Të njëjtën gjë e konstaton edhe raporti për të drejtat e njeriut i hartuar në vitin 2024.¹¹

Diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ishte trajtuar edhe në Raportin mbi zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi – Bazuar në rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, i publikuar në dhjetor 2023, bazuar në rastet e platformës, ku sipas këtij raporti, deri më 1 dhjetor 2023, në platformë kanë qenë të raportuara 39 raste të diskriminimit.¹² Kurse raporti i vitit 2024, i publikuar për Platformën, thekson që në fund të vitit 2024 kanë qenë të paraqitur 52 raste të diskriminimit.¹³

2.1. Raportimi i rasteve të diskriminimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Platformë - viti 2025 shënon rritje të besimit dhe efikasitetit në zgjidhjen e rasteve

Platforma, Grupi teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe partnerët mbështetës kanë inkurajuar në vazhdimësi raportimin e rasteve të diskriminimit në kuadër të platformës. Për këtë arsye, partnerët që mbështesin platformën, respektivisht *Terre des hommes* në Kosovë, vazhdimisht kanë investuar në avancimin e platformës, në kuptim të raportimit më të lehtë të rasteve nga ana e viktimave potenciale të diskriminimit. Po ashtu, edhe përditësimi dhe avancimi teknik i platformës është bërë përgjatë vitit 2024 dhe 2025, për ta lehtësuar paraqitjen e rasteve dhe marrjen/pranimin e informatës kthyesë tek palët që raportojnë.

Përkundër përpjekjeve dhe zhvillimit të platformës, edhe mungesa e raportimit të rasteve të diskriminimit përbën një sfidë më vete për institucionet e Republikës së Kosovës, ku një gjë e tillë është vërejtur edhe tek rastet e raportuara në kuadër të platformës. Hezitimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të raportuar rastet e diskriminimit, vërehet edhe nga numri i ankesave të dërguara tek Avokati i Popullit, përgjatë vitit 2022, duke pasur parasysh faktin që Avokati i Popullit është njëri ndër mekanizmat kryesorë të mbrojtjes nga diskriminimi. Numri i ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit për vitin 2022 është si në vijim: 10 komuniteti rom; 12 ai ashkali; 2 komuniteti egjiptian.¹⁴ Megjithatë, numri i raportuesve është rritur, sipas raportit të vitit 2023 të Avokatit të Popullit, nga 24 sa ishin në 2022, në 38 për vitin 2023.¹⁵ Për vitin 2024, për komunitetet është si në vijim: komuniteti rom 17, ai shkali 23, komuniteti egjiptian 10.¹⁶ Viti 2024 shënon rritje të raportimit në perspektivën e Avokatit të Popullit.

⁹ Po aty, f.81.

¹⁰ Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, 2023, Maj 2024, f.90.

¹¹ Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, 2024, Maj 2025, f.91.

¹² Shih më shumë, Raporti mbi zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi – Bazuar në rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian 2023.

¹³ Shih më shumë tek Raporti mbi zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi – Bazuar në rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, publikuar më 2025.

¹⁴ Përmbledhje e raportit vjetor të Avokatit të Popullit 2022, maj 2023, f. 9.

¹⁵ Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, për vitin 2023, f. 16.

¹⁶ Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, për vitin 2024 f. 18.

Ndërkaq sa i përket rasteve të raportuara në Platformën Kombëtare, përgjatë vitit 2025, në krahasim me vitin 2024 ka pasur rritje të numrit të raportimeve. Rritja e përvitshme e numrit të raportimeve ka qenë rezultat i punës së përbashkët të ZQM/ZKM, Grupit Teknik si dhe Terre des Hommes, përfshirë edhe në fushatat promovuese për raportimin e rasteve në platformë, të cilat fushata kanë rezultuar me takime të ndryshme me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.



Hulumtimi Kombëtar mbi Antigjipsizmin në Kosovë, publikuar në Maj 2022, lidhur me raportimin e rasteve të diskriminimit nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ka gjetur se njëra ndër arsyt e hezitimit në raportim të rasteve është trajtimi i dobët i tyre nga ana e institucioneve. Po ashtu, disa frikësohen që nuk kanë prova të mjaftueshme për rastin, kurse disa të tjerë nuk kanë dijeni se si të raportojnë rastin. Për këtë arsye, shumica e raportuesve ngurrojnë të raportojnë pasi që besojnë që rasti i tyre nuk do të mund të trajtohet mirëfilli.¹⁷

Edhe pse është punuar në vazhdimësi në inkurajimin e raportimit të rasteve të diskriminimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në kuadër të rasteve të raportuara në platformë është vërejtur hezitimi në raportim të rasteve për mbrojtje nga diskriminimi. Kjo mund të matet, duke pasur parasysh numrin e madh të rasteve anonime që janë raportuar, për çka edhe shumë raste nuk kanë mundur të adresohen, në mungesë të palës së dëmtuar apo palës anonime. Megjithatë, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duhet të inkurajohen vazhdimisht, që me rastin e raportimit në platformë, të japin edhe një numër të kontaktit të tyre ose kontakt tjetër, ashtu që të kontaktohen, e pastaj edhe të vendosin nëse nuk duan që identiteti i tyre të zbulohet. Një gjë të tillë e mundësojnë rregullat e vendosura nga Grupi Teknik për platformën. Kështu, nga 11 raste të paraqitura në vitin 2022 në platformë, 6 prej tyre, ose mbi 50% kanë qenë anonime. Në anën tjetër, nga 21 raste që janë raportuar në platformë në vitin 2023, 11 prej tyre ose 50% kanë qenë të raportuara si anonime. Kjo tregon edhe për gjendjen e hezitimit të paraqitjes së rasteve nga ana e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke pasur parasysh shkallën e anonimitetit të rasteve të raportuara. Raportimet anonime mund të lidhen edhe me frikën për të raportuar haptazi rastin, konstatim ky që Avokati i Popullit e ka dhënë në raportin e vitit 2022.

Ndërkohë, në vitin 2024, në platformë janë raportuar 13 raste. Ajo që është vërejtur për dallim nga vitet e tjera, ka të bëjë me faktin se vetëm një rast është paraqitur si rast anonim. Viti 2025 po ashtu shënon rritje të madhe sa i përket raportimit të rasteve dhe vetëm njëri (1) nga 17 rastet është paraqitur si anonim.

Siç mund të vërehet, gjatë vitit 2025 ka pasur një arritje në kuptimin e zvogëlimit të numrit të rasteve të raportuara në mënyrë anonime: kësisoj, edhe pse është shënuar një rritje sa i përket raportimit të rasteve, nga 17 rastet e raportuara, vetëm një i tillë është paraqitur si anonim krahasim me vitin 2024, ku në platformë janë paraqitur 13 raste, ndërsa vetëm një (1) rast anonim.

¹⁷ Ann Morton Hyde - Dr Iulius Rostas - Drenushë Telaku - Delia Spatareanu, "National Research on Antigypsyism in Kosovo", May 2022, f.56.



Përkundër arritjes në zvogëlimin e numrit të rasteve anonime në vitet 2024 dhe 2025, është vërejtur kryesisht hezitim i palëve raportuese që të bashkëpunojnë në trajtimin e rasteve nga institucionet kompetente, duke refuzuar që të përgjigjen ose të sjellin prova për atë që kanë pohuar me rastin e raportimit.¹⁸ Në bazë të analizës së ekipit të platformës, ky hezitim ka ndodhur për arsyt si në vijim:

- 1.** Mungesa e njohurive tek palët lidhur me konceptin e diskriminimit;
- 2.** Pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme për rastin e paraqitur, duke u bazuar vetëm në përshkrimin e ngjarjes - pa elemente të tjera mbështetëse;
- 3.** Konfuzioni mes konceptit të mbrojtjes nga diskriminimi dhe ndihmës juridike falas, duke i ngatërruar këto dy aspekte me nevojat specifike për ndihmën juridike të këtyre komuniteteve;
- 4.** Mungesa e njohurive të nevojshme për raportimin e rasteve.

Raportimi në mënyrë anonime mund të cilësohet po ashtu sfidë në raportimin e rasteve të diskriminimit, nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, e cila duhet të adresohet me kujdes nga Grupi Teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, partnerët dhe institucionet kompetente për zbatimin e LMD-së.

Megjithatë, siç u theksua, në vitin 2024 dhe 2025 ka pasur përmirësim të këtij komponenti, duke rezultuar me vetëm një rast të raportuar në mënyrë anonime.

Madje viti 2025 mund të konsiderohet vit i suksesshëm në rritjen e vetëdijesimit institucional nga Platforma për dy arsye:

- 1.** Është evidentuar një reduktim i rasteve të raportuara në mënyrë anonime, së bashku me rritjen e numrit të raportuesve, që dëshmon besim të rritur në funksionalitetin dhe kredibilitetin e platformës;
- 2.** Palët kanë marrë përgjigje të menjëhershme nga platforma, ndërsa edhe institucionet kanë qenë efikase në reagim ndaj rasteve të paraqitura në platformë.¹⁹

¹⁸ Kjo ka ndodhur në rastin e raportuar nga K.K dhe atë nga L.Q, të cilët nuk janë paraqitur për të sjellë dëshmi për atë që kanë pohuar kur kanë raportuar rastin në Platformë.

¹⁹ Mund të përmendim rastet e reagimeve nga Prokuroria Themelore në Prizren, Gjakovë apo edhe institucionet private.

■ 3. MEKANIZMAT INSTITUCIONALË TË MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI SIPAS LMD-SË DHE PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI SI MEKANIZËM MBËSHTETËS

Në kuptim të mekanizmave institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si udhërrëfyes duhet të merret Ligji në fuqi për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L -021 (LMD). Mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në bazë etnike dhe të gjitha bazave tjera të diskriminimit janë: Avokati i Popullit; Gjykatat kompetente; Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; Ministrinë dhe komunat, përmes zyrtarëve të caktuar për raportim të diskriminimit; Prokurori i shtetit dhe Policia e Kosovës, kur diskriminimi rezulton me vepër penale, por edhe institucionet e tjera, sipas mandatit të përcaktuar me ligje të veçanta, siç është rasti i Inspektoratit të Arsimit, etj.

Ndërkaq, si mekanizma mbështetës (alternativë) për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë, rom, ashkali dhe egjiptian, janë: Grupi Teknik i punës për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, e cila funksionon në kuadër të Grupit Teknik, si dhe administrohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, si sekretariat i grupit teknik.

Nga numri i rasteve të raportuara deri më tani në kuadër të platformës, si dhe duke pasur parasysh bashkëpunimin ndërinstytucional, është treguar se platforma ka funksionuar si mekanizëm alternativ që ka ndihmuar institucionin në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Numri i 69 rasteve të raportuara në platformë, si dhe 33 rasteve të adresuara me sukses deri tani, është një indikator i qartë për një bashkëpunim të mirë midis ekipit të platformës dhe institucioneve të tjera kompetente në zbatimin e LMD-së.



3.1. Grupi Teknik për mbrojtje nga diskriminimi për komunitet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës

Grupi Teknik për mbrojtje nga diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është themeluar me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si mekanizëm institucional për të adresuar rastet dhe për të luftuar diskriminimin e këtyre komuniteteve, mbi të gjitha në bazat që i parasheh legjislacioni në fuqi. Ndër të tjera, ky grup ka marrë për obligim të adresojë të gjitha ankesat për të mbrojtur nga diskriminimi pjesëtarët e këtyre komuniteteve.²⁰ Përveç Kushtetutës së Kosovës dhe LMD-së, Grupi Teknik ka për qëllim të zbatojë deklaratën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian (Deklarata e Poznanit).

Fushëveprimi kryesor i grupit teknik është mbrojtja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga diskriminimi.²¹ Përbërja e grupit teknik përfshin edhe përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, si përfaqësues të ministrive përkatëse; dy (2) përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK); Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKPK); Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP); përfaqësues të shoqërisë civile, mes tjerësh.²² Në vazhden e punës, duke marrë parasysh edhe nevojat, përbërja e grupit teknik është zgjeruar tutje me partnerë të tjerë relevantë, duke qenë se me vendim lejohet një gjë e tillë. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit mbetet kryesuese e grupit teknik, dhe gjithashtu ka mandat udhëheqjen e sekretariatit të këtij grupi.

Fushëveprimi i grupit teknik përfshin çështjet vijuese:

1. Përgjegjësia për të zbatuar çështjet që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian;
2. Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për të adresuar ankesat për diskriminim nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
3. Procedimi i ankesave kundër diskriminimit nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian tek institucionet kompetente;
4. Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për të siguruar mbështetje ligjore, për të siguruar mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
5. Realizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e publikut, për të parandaluar diskriminimin ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
6. Ndërmarrja e aktiviteteve të tjera që kanë për qëllim adresimin e rasteve të diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.²³

Me qëllim të zbatimit të mandatit të këtij Grupi, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit ka themeluar Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo platformë është duke shërbyer si mekanizëm alternativ për luftimin e diskriminimit për këto komunitete dhe si mekanizëm mbështetës në zbatim të mandatit të grupit teknik, që është krijuar sipas vendimit të Kryeministrit për themelimin e këtij grupi.

Përgjatë viteve 2021, 2022, 2023, e me qëllim të adresimit të çështjeve për mbrojtjen nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, Grupi Teknik ka mbajtur 8 (tetë) takime.²⁴ Grupi Teknik, sipas

²⁰ Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nr.139/2020, datë 11.09.2020, pika 3.1.

²¹ Po aty, pika 1.

²² Po aty, pika 1.

²³ Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nr.139/2020, datë 11.09.2020 pika 3.

²⁴ Takimet e Grupit Teknik të mbajtura më: 18.05.2021; 04.08.2021; 25.11.2021; 29.03.2022; 05.09.2022; 15.12.2022; 07.02.2023; 11.07.2023

vendimit për themelimit duhet të mbajë së paku 4 takime brenda vitit, duke përfshirë një takim në çdo 3 muaj. Në anën tjetër, Grupi Teknik për vitin 2024 ka mbajtur 2 takime të rregullta dhe 2 sesione informuese përkitazi me çështjen e platformës dhe promovimin e punës së saj.²⁵

Në vitin 2025, Grupi Teknik ka mbajtur dy (2) takime. Takimi i parë është mbajtur më 23 prill 2025, me ç'rast është prezantuar raporti "Luftimi i diskriminimit bazuar në rastet e Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (2022-2024)". Nga ky takim kanë dalë rekomandime konkrete në lidhje me Platformën.

Takimi i dytë i vitit 2025 i Grupit Teknik është realizuar më 6 nëntor 2025. Qëllimi i takimit ka qenë organizimi i fushatës për Platformën Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por edhe është paraqitur edhe progresi i punës së Grupit Teknik Punues për Mbrojtjen nga Diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pasur me planifikim dhe koordinim të aktiviteteve mes institucioneve. Gjatë takimit, është diskutuar hollësisht koncepti i fushatës së lansimit, objektivat kryesorë të saj, grupet e shënjestruara dhe mesazhet kyçe, me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për ekzistencën dhe funksionimin e platformës, si dhe inkurajimin e raportimit të rasteve të diskriminimit.



Fushata synon të arrijë drejtpërdrejt komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe publikun më të gjerë, përmes aktiviteteve informuese, materialeve promovuese dhe komunikimit publik të koordinuar. Po ashtu, Grupi Teknik më 14 nëntor 2025 ka mbajtur edhe tryezën Kombëtare për Luftimin e Antigjipsizmit, e organizuar nga Roma Versitas Kosova, në bashkëpunim me ZQM/ZKM. Ky aktivitet kombëtar i nivelit të lartë ka mbledhur përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë për të diskutuar dimensionet strukturore të Antigjipsizmit, në Kosovë²⁶.

ZQM/ZKM dhe Grupi Teknik, me përkrahje nga TDhK, ka organizuar ngjarjen - konferencën e inicimit të fushatës vetëdijesuese për Platformën Kombëtare, me fokus tek përkushtimi dhe promovimi i parimeve të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies, duke kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në luftimin e diskriminimit, forcimin e qeverisjes demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në nisje të fushatës është potencuar synimi i fuqizimit të mbrojtjes institucionale dhe shoqërore ndaj diskriminimit, duke mundësuar raportim të lehtë dhe transparent të rasteve të padrejtësive dhe promovimin e barazisë për të gjithë qytetarët.

Në takimet e Grupit Teknik, përveç anëtarëve, e sipas vendimit për themelimit, ftohen edhe organizata të tjera të shoqërisë civile. Përfshirja e tyre ka për qëllim të pasurojë diskutimet me perspektiva nga terreni, të sigurojë shkëmbim të përvojave praktike dhe të kontribuojë në adresimin më efektiv të rasteve dhe sfidave që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi.

Me qëllim të funksionimit efektiv, siç u theksua më sipër, puna e Grupit Teknik organizohet dhe koordinohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim pranë

²⁵ Takimet e Grupit Teknik të mbajtura më: 20.05.2024 dhe 10.10.2025 si dhe takimet apo sesionet të mbajtura me 09.09.2024 dhe me 18.11.2024.

²⁶ Të dhëna të dërguara nga ZQM, me datë 08.12.2025.



Zyrës së Kryeministrit. Ky grup, por edhe vetë funksionimi i platformës, mbështetet nga stafi profesional, përkatësisht eksperti ligjor dhe administratori. Eksperti ligjor është përgjegjës për analizimin dhe përcjelljen e rasteve të raportuara përmes platformës, si dhe për hartimin e shkresave zyrtare për adresimin e tyre tek institucionet kompetente. Po ashtu, eksperti ligjor harton rekomandime konkrete për nevojat dhe veprimtarinë e Grupit përkatës, duke kontribuar në përmirësimin e koordinimit dhe efektivitetit të punës së tij.

Nga rastet që janë trajtuar nga ekipi profesional që mbështet Grupin Teknik dhe platformën, 2 prej tyre janë raportuar në grupin teknik, kurse 5 prej tyre në Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, gjatë vitit 2019, përderisa Grupi Teknik nuk ka qenë akoma i themeluar.

Që nga funksionalizimi i Platformës, 64 raste të reja janë paraqitur direkt në platformë. Kjo tregon që Platforma ka pasur efekt të konsiderueshëm në aktivizimin e grupit teknik dhe plotësimin e përmbushjes së mandatit të tij. Pas lansimit të platformës dhe rasteve të raportuara në vitin 2020 në grupin teknik, ndërsa në vitin 2019 në Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, janë regjistruar dhe trajtuar nga platforma, duke rritur kështu numrin total të rasteve në platformë në 39 raste deri më 15 nëntor 2023, si dhe në 52 raste deri më 1 dhjetor 2024, e 69 raste deri më 31 Dhjetor 2025.

Që nga themelimi i tij, Grupi Teknik ka luajtur rolin e një mekanizmi funksional të rëndësishëm, e që ka shërbyer si bazë e funksionimit të platformës. Sipas rasteve të raportuara në platformë, Grupi Teknik ka hartuar qëndrime dhe vlerësime për luftimin e diskriminimit. Gjatë vitit 2024, Grupi Teknik ka mbajtur takime të rregullta me IAP-në, me qëllim të ndërveprimit e bashkërendimit të veprimeve për luftimin e diskriminimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Siç është theksuar edhe më sipër, përveç takimeve të rregullta, Grupi Teknik ka praktikuar edhe mbajtjen e sesioneve në formë takimesh, me mekanizmat përkatës për luftimin e diskriminimit.

4. PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN DHE RASTET E RAPORTUARA NGA QERSHORI 2022 DERI MË 31 DHJETOR 2025

Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbështetur vlerat e përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, si dhe për të luftuar diskriminimin ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Me përkushtimin për të luftuar dhe parandaluar diskriminimin ndaj këtyre komuniteteve, platforma përbën masë afirmative plotësuese për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Platforma është lansuar në qershor të vitit 2022, e që nga funksionalizimi i saj, deri më 31 dhjetor 2025, janë bërë 3.5 vite punë e këtij mekanizmi.




Tabela: Statistika të përgjithshme nga Platforma kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me rastet e raportuara.

Që nga funksionalizimi i saj, deri më 31 dhjetor 2025, platforma ka shënuar tërësisht **23,431 vizitorë**. Në total janë **908 llogari të hapura dhe aktive**. Vetëm gjatë vitit 2025, në Platformë janë hapur **36 llogari** dhe janë raportuar 17 raste si dhe në platformë gjatë 2025 janë qasur **1535 vizitorë**.

Platforma operon me mision të qartë të regjistrimit dhe trajtimit të rasteve të diskriminimit të drejtpërdrejtë, të tërthortë, kolektiv, gjuhës së urrejtjes, si dhe formave të tjera të diskriminimit ndaj komuniteteve rom,

ashkali dhe egjiptian. Ajo synon të sigurojë qasje të barabartë dhe të lehtësojë raportimin e rasteve të diskriminimit, me fokus të veçantë në komunitetet e lartpërmendura rom, ashkali dhe egjiptian. Platforma po ashtu luan rol vendimtar në ngritjen e vetëdijes mbi legjislacionin përkatës dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi. Në mbështetje të vizionit të trajtimit të barabartë kushtetues dhe ligjor për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga karakteristikat e ndryshme personale, platforma përpiket të nxisë një shoqëri pa diskriminim ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në bazë të gjinisë, moshës, statusit martesor, gjuhës, paaftësisë fizike ose mendore, orientimit seksual, kombësisë, opinionit ose besimit politik, fesë ose besimit, përkatësisë etnike ose shoqërore, racës, pasurisë, ose ndonjë statusi tjetër.²⁷

Platforma shërben si rrugë jetike për qytetarët pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të raportuar rastet e diskriminimit, pavarësisht se kur dhe ku ato ndodhin. Ajo synon të promovojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve në luftim e parandalim, në mënyrë aktive dhe efektive, të diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve. Përveç rolit të saj si mekanizëm raportues, platforma është qendër përmbledhëse informacioni, që ofron përditësime mbi rastet e diskriminimit, masat parandaluese, legjislacionin kombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare për mbrojtje nga diskriminimi, aktivitetet e ndryshme që organizohen nga Qeveria dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, si dhe raportet vjetore. Platforma virtuale përfshin një faqe interneti, një bazë të dhënash, si dhe aplikacionin mobil për përdoruesit, të përditësuar rregullisht me materiale politikash dhe praktike, duke përfshirë legjislacionin rajonal dhe atë kombëtar, procedurat e veprimit si dhe udhëzimet.²⁸

Përdoruesit e platformës mund të raportojnë drejtpërdrejt rastet e diskriminimit, qoftë në lidhje me përvojat e tyre apo edhe incidentet që kanë parë vetë, edhe nëse nuk janë të prekur drejtpërdrejt.

Ekipi i platformës punon duke u bazuar në parimin e konfidencialitetit të palëve dhe ruajtjes së fshehtësisë zyrtare në trajtimin e rasteve të raportuara. Të gjitha rastet e raportuara shqyrtohen tërësisht nga stafi profesional dhe i referohen në mënyrë adekuate institucioneve përkatëse, në pajtim me Ligjin në fuqi për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD).²⁹

Themelimi i platformës është përmendur edhe në Raportin e progresit 2023, me ç'rast platforma vlerësohet si një mekanizëm për adresimin e rasteve të mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Megjithatë, theksohet që LMD mbetet jo-efektiv për luftimin e antigjipsizmit.³⁰ Po ashtu, platforma përmendet edhe në raportin e progresit për Kosovën 2025, ku theksohet fakti që janë raportuar 52 raste³¹,

²⁷ Po aty. Shih për më shumë Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, rom, ashkali dhe egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f.4-5.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Kosovo 2023 Report, Brussels, 8.11.2023, SWD(2023) 692 final, f.41.

³¹ COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2025 Report Accompanying the document COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS, p.41.

4.1. Rastet e adresuara nga Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian - Përshkrim i shkurtër i adresimit dhe veprimeve të ndërmarra në të gjitha rastet

Përgjatë periudhës, që nga themelimi dhe deri me datë 31 Dhjetor 2025, në platformë janë raportuar gjithsej 69 raste³², të cilat mund të ndahen në dy kategori si në vijim:

1. Rastet e raportuara në platformë dhe që janë adresuar dhe trajtuar nga institucionet kompetente;
2. Rastet e tjera të raportuara në platformë, të cilat nuk kanë rezultuar me diskriminim por janë trajtuar nga platforma.³³

Nga 3.5 vite të punës së saj në të gjitha rastet e pranuar në platformë, 33 prej tyre janë adresuar në tërësi nga institucionet, kurse 8 raste janë në procedurë trajtimi, e të cilat marrin kohë për shkak të procedurave institucionale të trajtimit, gjyqësor apo në drejtim tjetër. Nga këto gjatë raste, asnjëri prej tyre nuk janë raportuar në vitin 2025, për shkak se rastet e raportuara gjatë këtij viti, janë adresuar.

Në kuadër të rasteve të raportuara, ka edhe raste që Platforma nuk ka mundur t'i adresojë për arsye të ndryshme, e natyra e këtyre rasteve është si në vijim:

1. Raste vetëm të regjistruara, ku personi (subjekti) i diskriminuar dhe kontakti i tij/saj ka qenë i panjohur, ndërsa në përshkrimin të raportimit të tyre nuk kanë paraqitur dëshmi të diskriminimit. Zakonisht, përshkrimi në platformë për këto raste ka qenë shumë i shkurtër, e si i tillë i pamjaftueshëm, që rasti të iniciohet tutje në institucionet kompetente.
2. Rastet të cilat janë trajtuar, por që palët nuk kanë bashkëpunuar me platformën, duke mos sjellë prova konkrete për atë që kanë raportuar. Në këto raste, stafi profesional i platformës në vazhdimësi i ka kontaktuar palët për të sjellë dëshmi shtesë. Të tilla janë të raportuara 3 raste.
3. Platforma nuk ka qenë kompetente për trajtimin e rastit.

Në kuadër të këtyre rasteve, janë gjithsej 27 të tilla, të cilat Platforma për arsyt e theksuara më sipër (1-3) nuk ka mundur t'i trajtojë efektivisht. Megjithatë, të gjitha palët kanë marrë përgjigje. Siç është theksuar, 33 raste janë zgjidhur me sukses që nga lansimi i platformës, kurse për 9 raste tjera priten rezultatet sipas veprimeve të ndërmarra nga platforma.

1. Rasti i diskriminimit kolektiv ndaj komunitetit rom nga Obiliqi:

Lloji: Diskriminim kolektiv

Përshkrimi: Rasti përfshin komunitetin rom në Obiliq, të cilët përjetojnë diskriminim në lidhje me qasjen në banim dhe forma të tjera të pronës. Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përgatitur një raport të veçantë dhe ia ka përcjellë Avokatit të Popullit. Ky rast është adresuar nga Avokati i Popullit sipas një raporti *ex-officio*, publikuar më datë 18 nëntor 2023. Rasti është raportuar në vitin 2020.

³²Të gjitha rastet e përshkuara në këtë raport, janë vazhdimësi dhe përfshijnë rastet e raportuara në Platformë nga viti 2020 deri në vitin 2025. Rastet prej viteve 2020 deri në vitin 2024, që janë pjesë e këtij raporti, janë paraqitur edhe në raportet e tjera të publikuara për punën e Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në: qershor 2022 (Raporti 1), dhjetor 2023 (Raporti 2), mars 2025 (Raporti 3). Të gjitha këto raporte i dedikohen luftimit të diskriminimit përmes rasteve dhe punës së Platformës dhe janë publikuar dhe financuar nga TDhK. P.sh.: <https://www.tdh-kosovo.org/sq/raport-luftimi-i-diskriminimit-bazuar-ne-rastet-e-platfomes-kombetare-mbrojtje-nga-diskriminimi>, qasur më 06.12.2025.

³³Kjo kategori e rasteve sqarohet në pikën e radhës 5.1.2.



2. Rasti i diskriminimit nga Policia e Kosovës ndaj një pjesëtari të komunitetit rom:

Lloji: *Diskriminim individual/pjesëmarrja në çështjet publike*

Përshkrimi: Një pjesëtar i komunitetit rom pretendon se është diskriminuar nga Policia e Kosovës, për shkak se të njëjtit nuk i është lejuar gëzimi i lirisë së tubimit, në kohën e pandemisë Covid-19. Platforma ka kryer një hetim dhe ka përcaktuar bazat e diskriminimit. Rasti tani është duke u shqyrtuar nga Gjykata Themelore kompetente, bazuar në nenet përkatëse të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ndonëse LMD parasheh mundësi që rastet e diskriminimit të trajtohen me urgjencë nga gjykatat, që nga viti i paraqitjes së këtij rasti në gjykatë, akoma nuk ka pasur ndonjë vendim. Rasti është raportuar në vitin 2020.

3. Rasti i diskriminimit ndaj një gruaje nga komuniteti rom:

Lloji: *Diskriminim individual që përbën veprë penale*

Përshkrimi: Një grua nga komuniteti rom përballet me diskriminim mbi baza të shumta, duke përfshirë diskriminimin me vepra penale. Platforma Kombëtare ka bërë një raport të posaçëm duke theksuar diskriminimin përmes sulmit fizik (veprës penale) dhe gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale. Çështja aktualisht është në shqyrtim nga gjykatat kompetente dhe monitorohet nga Platforma. Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit ka nxjerrë raport me rekomandime, ku ka trajtuar me theks të veçantë aspektin e diskriminimit përmes gjuhës së urrejtjes.³⁴ Rasti është raportuar në vitin 2019.

4. Rastet e mohimit të shtetësisë për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore:

Lloji: *Diskriminim i supozuar, por që u gjet si jodiskriminues*

Përshkrimi: Katër qytetarë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian pohojnë se kërkesat e tyre për shtetësi janë refuzuar për shkak të diskriminimit. Platforma Kombëtare i hetoi këto raste dhe mori përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme, ku deklarohet se mohimi nuk ishte diskriminues, por për shkak të mosplotësimit të kërkesave ligjore nga ana e aplikantëve. Rastet janë cilësuar të mbyllura. Rastet janë raportuar në vitin 2022.

5. Rasti i diskriminimit të vazhdueshëm nga një person fizik, që pengon qasjen në pronë:

Lloji: *Diskriminim individual/trajtim i pabarabartë nga institucionet që administrojnë drejtësinë*

Përshkrimi: Një qytetar, i cili është pjesëtar i komunitetit rom, është i përfshirë në një rast në vazhdim që përfshin hetimin penal. Platforma është në kontakt me palën e prekur për të parandaluar diskriminimin e mëtejshëm. Diskriminimi në këtë rast i atribuohet një personi fizik dhe ka të bëjë me pengimin e ankuesit në pronë. Ky rast është adresuar tek Avokati i Popullit dhe akoma nuk ka pasur ndonjë vendim/rekomandim lidhur me këtë rast. Platforma do të vazhdojë të monitorojë dhe trajtojë këtë rast, pasi diskriminimi është i vazhdueshëm ndërsa Grupi Teknik do të kërkojë nga Avokati i Popullit që t'i trajtojë me prioritet këto raste. Subjekti i cili ka shkaktuar diskriminimin në këtë rast është person fizik publik, përfshirë edhe Prokurorin e Shtetit. Platforma ka ri-adresuar rastin, për shkak të vonesave, por akoma nuk ka marrë përgjigje ose nuk ka informacion për ndonjë përfundim konkret. Rasti është raportuar në vitin 2022.

6. Rasti i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit kolektiv i promovuar përmes rrjeteve sociale:

Lloji: *Diskriminim kolektiv dhe gjuhë urrejtjeje*

Përshkrimi: Një qytetar shqiptar i Republikës së Kosovës është përfshirë në gjuhë të urrejtjes përmes rrjeteve sociale, me shënjestër komunitetet. Platforma e ka trajtuar këtë rast si diskriminim që përbën veprë penale. Platforma ka nisur procedurat e nevojshme dhe ka bërë kallëzimin penal pranë institucioneve kompetente. Rasti është raportuar në vitin 2022.

³⁴"Raport me rekomandime i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës", Ex-officio Nr. 468/2019, Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë, 9 dhjetor 2019.

7. Rasti i diskriminimit në arsimin e lartë:

Lloji: Diskriminim individual/diskriminim në fushën e arsimit

Përshkrimi: Një qytetare pjesëtare e komunitetit rom është përballur me diskriminim lidhur me arsimin e lartë. Platforma ka pranuar përgjigje nga institucioni (Universiteti) i përfshirë në këtë rast. Në përgjigjen e tyre janë dhënë sqarime për procedurën e regjistrimit të saj në Universitet dhe institucioni ka sqaruar arsyen ligjore të mos-regjistrimit të saj. Rasti është raportuar në vitin 2023.

8. Rasti i diskriminimit të vazhdueshëm në punësim nga Ministria e Shëndetësisë:

Lloji: Diskriminim individual/diskriminim i vazhdueshëm dhe trajtim jo i barabartë

Përshkrimi: Një qytetar i komunitetit egjiptian ka raportuar diskriminim të vazhdueshëm në punësim nga Ministria e Shëndetësisë. Platforma ka analizuar dhe trajtuar rastin për të adresuar çështjet e diskriminimit. Rasti është adresuar me sukses dhe ka përfunduar me Aktgjykim të Gjykatës Themelore, C. nr. 400/2019, të datës 18.05.2023, i cili ka vërtetuar diskriminimin indirekt nga MSH. Aktgjykimi i Gjykatës konstaton diskriminim indirekt të të njëjtit, për shkak të mos-ofrimit të mundësive të barabarta për punësimin e tij.³⁵ Rasti është raportuar në vitin 2023.

9. Rasti i gjuhës së urrejtjes me rastin e festimit të ditës së komunitetit Egjiptian³⁶:

Lloji: Diskriminim individual/gjuhë e urrejtës

Përshkrimi: Një qytetar shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, përmes postimit në faqen zyrtare në Facebook të Kryeministrit të Kosovës, është përfshirë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe shprehjes së mos-durimit ndaj pjesëtarëve të komunitetit egjiptian. Rasti është adresuar në organet kompetente si diskriminim që përbën vepër penale. Platforma nuk është informuar për ndonjë rezultat sa i përket këtij rasti. Rasti është raportuar në vitin 2023.

10. Diskriminimi i 25 fëmijëve rom dhe ashkali nga komuna e Fushë Kosovës dhe mohimi i të drejtës në arsim:

Lloji: Diskriminim kolektiv/qasje e pabarabartë në fushën e arsimit

Përshkrimi: 25 fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali iu është mohuar vazhdimi i mësimin alternativ nga një shkollë në komunën e Fushë-Kosovës. Rasti ka ndodhur në vitin 2021 dhe është adresuar nga platforma në vitin 2023, pas raportimit nga TDhK, pasi që vetë TDhK ka mbështetur mësimin alternativ të këtyre fëmijëve në shkollën "Selman Riza" në Fushë-Kosovë. Rasti është adresuar në Inspektoratin e Arsimit dhe tek Avokati i Popullit. Nga Inspektorati i Arsimit nuk është pranuar asnjë përgjigje, kurse Avokati i Popullit e ka regjistruar këtë rast në prill të vitit 2023. Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit ka nxjerrë raportin nr. 637/2023, me ç'rast ka konstatuar diskriminimin e nxënësve dhe ka urdhëruar Komunën e Fushë-Kosovës për marrjen e masave. Rasti ka rezultuar me sukses dhe njoftimi për këtë rast ka ardhur në vitin 2024. Rasti është raportuar në vitin 2023.

11. Diskriminimi i fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në një shkollë në komunën e Prizrenit:

Lloji: Diskriminim kolektiv/Parandalim i diskriminimit

Përshkrimi: Rasti është raportuar në platformë në vitin 2023 dhe është raportuar publikisht nga gazeta Nationale. Sipas rrethanave të rastit, është raportuar për një shkollë në Prizren që ka bërë ndarje të nxënësve në klasa sipas përkatësisë etnike. Platforma e ka adresuar rastin dhe janë marrë masa të menjëhershme nga Drejtoria Komunale në Prizren, duke parandaluar diskriminimin. Rasti është raportuar në vitin 2023.

³⁵ Ky rast sqarohet edhe në pjesën e mëposhtme, si rast i platformës i cili ka rezultuar me sukses.

³⁶ Rastet 9-13 janë paraqitur në Raportin mbi zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi – Bazuar në rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, publikuar në 23 dhjetor 2023 nga Platforma.

12. Diskriminimi i nxënësve nga një shkollë në komunën e Fushë-Kosovës:

Lloji: *Diskriminim individual/Parandalim i diskriminimit*

Përshkrimi: Rasti është raportuar në komunën e Fushë-Kosovës, ku një shkollë fillore e kësaj komune i ka mohuar një nxënëseje të klasës VI vazhdimin e shkollimit, me vendimin e drejtorit të shkollës, me arsyetimin e përsëritjes së vitit shkollor. Rasti, me pëlqimin e prindërve, është adresuar në Inspektoratin e Arsimit dhe platforma ka marrë përgjigje dhe inspektorati ka rekomanduar masë disiplinore ndaj drejtorit të shkollës, si dhe është adresuar me sukses. Rasti është raportuar në vitin 2023.

13. Diskriminimi i dy nxënësve me aftësi të kufizuara nga komuniteti rom:

Lloji: *Diskriminim individual/Diskriminim në arsim*

Përshkrimi: Dy nxënës me aftësi të kufizuara nga komuna e Fushë-Kosovës nuk kanë mundur të regjistrohen në një qendër (shkollë speciale), për shkak se Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka arritur ta krijojë komisionin për të vërtetuar shkallën e aftësisë së kufizuar. Qasja e tillë e Komunës i ka pamundësuar atyre vijimin e rregullt të shkollimit. Rasti është adresuar në komunën e Fushë-Kosovës dhe është në monitorim nga ana e Platformës. Platforma akoma nuk ka pranuar përgjigje konkrete lidhur me zgjidhjen e rastit, pasi që komuna është kompetente për formimin e komisionit përkatës. Rasti është raportuar në vitin 2023.

14. Rasti i fëmijëve romë që bredhin në rrugë, si dhe diskriminimi me mosveprim

Lloji i diskriminimit: *Nuk përbën diskriminim*

Rasti ka të bëjë me katër (4) fëmijë romë dhe është raportuar nga një person i tretë. Nga 4 fëmijët, më i vogli ka qenë në moshën 8 vjeçare dhe më i madhi në moshën 14 vjeçare. Sipas raportimit, fëmijët janë parë duke bredhur në lagjen Dardania në Prishtinë, në ora 5 të mëngjesit, pa përcjellje të ndonjë personi të rritur. Për këtë, raportuesja pohon se e ka njoftuar Policinë e Kosovës në ora 5.27, respektivisht Stacionin Jug. Po ashtu sipas raportimit, të njëjtit fëmijë janë parë sërish duke luajtur tek kontejnerët e mbeturinave në lagjen Dardania në Prishtinë. Lidhur me këtë rast është njoftuar dy herë Policia e Kosovës, ditën kur raportuesja i ka vërejtur fëmijët. Ekipi profesional i platformës ka trajtuar rastin, duke njoftuar Policinë e Kosovës për mos-reagim në rastin konkret, si dhe rastin e konsideron të adresuar, për shkak se i njëjti nuk kishte të bënte me diskriminim por me mosveprim të institucionit kompetent për mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike. Rasti është raportuar në vitin 2023.

15. Ankesa ndaj kompanisë Pastrimi në Komunën e Lipjanit

Lloji i diskriminimit: *Nuk përbën diskriminim*

Raportuesja e rastit pohon se të njëjtës i është bërë e padrejtë nga kompania e mbeturinave (Pastrimi) në Lipjan, si dhe që kompania ka dërguar tek përmbaruesi faturën prej 35 euro, ndërsa ankuesja pohon se ata kanë lidhje midis tyre, si dhe priret të besojë për padrejtësi. Raportuesja e rastit identifikohet me emër dhe e njëjta është njoftuar që rasti nuk ka të bëjë me diskriminim por me çështjen e ndihmës juridike falas, respektivisht përmbarimin e një fature të ujit. Platforma e konsideron të adresuar rastin, pasi që lidhur me të njëjtin i është drejtuar kompanisë Pastrimi në Lipjan, përmes njoftimit për situatën e paraqitur ndaj një pjesëtareje të komunitetit. Rasti është raportuar në vitin 2023.

16. Rasti i fëmijëve romë pa kujdes prindëror

Lloji i diskriminimit: *Nuk përbën diskriminim*

Rasti ishte raportuar nga një person i tretë dhe ishte trajtuar në janar të vitit 2024. Sipas këtij rasti, tre (3) fëmijë të një pjesëtareje të komunitetit rom kishin mbetur pa kujdes prindëror për shkak të vdekjes së nënës së tyre, si dhe martesës të pjesëtarit të komunitetit rom. Me rastin e pranimit të raportimit,

ekipi profesional i platformës ka kontaktuar raportuesin dhe Qendrën për Punës Sociale (QPS) në Fushë Kosovë, me ç'rast ka marrë përgjigje nga QPS, që rasti ka qenë nën menaxhim të QPS-së nga shtatori i vitit 2020, si dhe që ai do të trajtohet më tutje. Rasti konsiderohet i trajtuar nga perspektiva e platformës.

17. Diskriminimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Lloji i diskriminimit: *Diskriminim racor*

Rasti ka të bëjë me diskriminimin e pretenduar të komuniteteve rom dhe ashkali nga ana e zyrtarëve kompetentë për regjistrimin e popullsisë, respektivisht zyrtarëve të angazhuar në procesin e regjistrimit të popullsisë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Diskriminimi dyshohet të ketë ndodhur përgjatë një takimi me pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës, respektivisht në Shkollën "Hivzi Sylejmani". Përgjatë takimit me temë procesin e regjistrimit të popullsisë, sipas raportimit, zyrtari i ASK-së disa herë ka përmendur fjalën "maxhup" duke iu referuar pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Raportuesja në raport lë të nënkuptohet se ajo dhe pjesëtarët e tjerë të komuniteteve rom dhe ashkali të pranishëm në takim janë ndier të diskriminuar. Pala raportuese nuk ka paraqitur ndonjë provë se ky lloj diskriminimi racor ka ndodhur, përkundër kërkesës nga Platforma. Platforma ka kontaktuar ASK-në dhe ka adresuar rastin, pa bashkëngjitur ndonjë provë konkrete në mungesë të tyre, megjithatë ASK ka mohuar të ketë ndodhur ndonjë lloj i tillë diskriminimi racor në rastin konkret, si dhe ka shprehur qëndrimin kundër dukurive të tilla. Rasti është raportuar në vitin 2024.

18. Diskriminimi racor nga Policia e Kosovës

Lloji i diskriminimit: *Diskriminim racor dhe etnik*

Rasti është raportuar nga një person publik, si dhe ka pasur të bëjë me përmendjen e etnisë të të dyshuarve nga Policia e Kosovës. Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, në një komunikatë publike ku tregohet për arrestimin e një burri të dyshuar për vepër penale, ka theksuar në komunikatë se i dyshuari dhe e dëmtuara janë nga radhët e komunitetit ashkali, duke theksuar etninë në komunikatë, ndonëse në komunikatat e tjera, të dyshuarit i kishte identifikuar vetëm si shtetas të Kosovës. Pala raportuese ka dërguar prova konkrete. Rasti është adresuar tek Avokati i Popullit, si dhe ka marrë përgjigje pozitive nga ky institucion më 20 gusht 2024. Rasti është raportuar në qershor të vitit 2024.

19. Diskriminimi i raportuar nga një kompani private

Lloji i diskriminimit: *Nuk përbën diskriminim*

Rasti ishte raportuar nga një person fizik si palë e diskriminuar, që kishte punuar në një kompani private. Pala e diskriminuar e kishte njoftuar kompaninë tri javë më herët për dorëheqjen nga puna. Pas dorëheqjes, kompania i kishte premtuar se pagën e mbetur do t'ia paguante deri me datë 10 të muajit përkatës. Megjithatë, kjo nuk kishte ndodhur. Platforma ka konfirmuar pranimin e rastit dhe ka komunikuar me palën e dëmtuar, duke e informuar që ky rast nuk përbën diskriminim, por çështje juridike e cila lidhet me moszbatimin e ligjit të punës. Po ashtu, ekipi i Platformës i ka kërkuar palës sqarim nëse në marrëdhënien e tij të punës ka pasur kontratë pune. Rasti është raportuar në vitin 2024.

20. Diskriminimi i komuniteteve rom dhe ashkali nga KEDS-i

Lloji i diskriminimit: *Diskriminim kolektiv etnik*

Rasti është raportuar nga një person fizik dhe disa OJQ që mbrojnë të drejtat e komuniteteve rom dhe ashkali. Rasti ka të bëjë me një ankesë të pranuar ku pretendohet që për 24 vite, përkundër kërkesave të vazhdueshme, pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në Obiliq, nuk i është rregulluar tensioni i lartë



i energjisë elektrike. Ekipi profesional i Platformës ka kërkuar që të dorëzohen provat shtesë përkatëse, respektivisht kërkesat që i janë drejtuar KEDS-it. Nga provat e pranuar në muajin gusht 2024, rezulton që 160 banorë të komuniteteve rom dhe ashkali, më datë 05.12.2019, kanë dorëzuar një kërkesë në KEDS, ku elaborojnë që një pjesë e madhe e fshatit Plemetin ka probleme me furnizimin me energjinë elektrike dhe rrjetin, si dhe aty kanë kërkuar trafostacion të ri të energjisë elektrike. Rasti është adresuar nga Platforma dhe pritet përgjigje zyrtare, për shkak se bëhet fjalë për diskriminim kolektiv të një numri të madh të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Rasti është raportuar në vitin 2024.

21. Diskriminimi i pjesëtarit të komunitetit ashkali, që përbënte vepër penale

Lloji i diskriminimit: *Diskriminim kolektiv etnik*

Përgjatë vitit 2024, Platforma ka trajtuar rastin e një pjesëtarit të komunitetit ashkali. Rasti kishte të bënte me uzurpim të lokalit nga një person fizik. Ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar disa herë palën e diskriminuar dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të. Po ashtu, janë adresuar disa shkresa zyrtare në drejtim të Gjykatës Themelore në Prizren. Rasti ka përfunduar me sukses, ndërsa në shtator të vitit 2024, palës i është liruar prona e tij sipas Akgjykimit të Gjykatës kompetente në Prizren, C.nr. 1791/2023, datë 2 gusht 2024.

22. Rastet e raportuara për martesat e hershme

Në platformë janë raportuar edhe dy (2) raste të cilat kanë të bëjnë me martesat e hershme, respektivisht rastet e dy vajzave të komuniteteve rom dhe ashkali që janë raportuar të kenë krijuar bashkësi jashtëmartesore nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare. Njëri nga rastet është paraqitur në Komunën e Prizrenit, kurse tjetri në Obiliq. Në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional për martesat e hershme, ekipi profesional i Platformës ka dërguar rastet në Policinë e Kosovës si dhe në QPS-në e Komunës së Prizrenit dhe atë të Obiliqit, si dhe këto raste konsiderohen të adresuara. Këto janë raportuar në vitin 2024.

23. Rasti i pretendimit për gjuhën e urrejtjes

Lloji i diskriminimit: *Gjuhë e urrejtjes*

Një raportues ka pretenduar që portali Korrekt Press ka përhapur gjuhë të urrejtjes, duke qenë që e ka shfaqur një person që shikonte një ndeshje të futbollit ku luante Spanja. Sipas pretendimeve, portali në fjalë e kishte cilësuar djalin e shfaqur në artikull si pjesëtar të komunitetit rom, në vend se të cilësohej si pjesëtar i komunitetit ashkali. Rasti është duke u analizuar nga ana e Platformës, e për këtë është paraqitur një raport analitik ligjor, i brendshëm. Rasti është raportuar në vitin 2024.

24. Rasti i varrezave rome në komunën e Mamushës

Diskriminim kolektiv

Në muajin dhjetor të vitit 2024, në kuadër të Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit është raportuar nga një aktivist i diasporës rome një rast i vjetër që ka të bëjë me një kontest në mes të komunës së Mamushës dhe pjesëtarëve të komunitetit rom në Mamushë.

Këtu bëhet fjalë për një çështje të ndjeshme të varrezave të komunitetit rom që konsiderohen trashëgimi e rëndësishme e këtij komuniteti. Në vendin ku janë të vendosura këto varreza, komuna e Mamushës ka lejuar ndërtimin e një xhamie. Rasti është kontestuar dhe sipas pretendimit të palës raportuese, i njëjti konsiderohet racizëm dhe diskriminim. Ekipi profesional i Platformës ka pranuar këtë rast dhe e ka trajtuar gjatë vitit 2025. Aktualisht rasti është adresuar nga Avokati i Popullit dhe është proceduar në Gjykatë për trajtim.³⁷

³⁷ Ky rast është raportuar me 6 dhjetor 2024. Është parashtruar padi për të zgjidhur kontestin pronësor me komunën e Mamushës. Po ashtu, për këtë çështje është paraqitur edhe një shkresë informuese të Avokati i Popullit.

25. Rasti i diskriminimit publik të futbollistit B.J.

Lloji i diskriminimit: Gjuhë e urrejtjes dhe racizëm

Rasti³⁸ i futbollistit nga Fushë Kosova B.J, pjesëtar i komunitetit ashkali, ka qenë rast publik. Ai është sulmuar fizikisht nga prindi i një fëmije që ishte pjesë e ndeshjes së futbollit që zhvillohej atë ditë, ndeshje e grup-moshave 15 vjeç, ku ky futbollist pretendohet të jetë fyer po ashtu mbi baza racore dhe të ngjyrës së lëkurës, duke u etiketuar me terma fytes. Policia e Kosovës ka ndaluar personin e dyshuar M.K., ndërsa ky person ishte dërguar në mbajtje për 48 orë. Rasti i futbollistit nga komuniteti ashkali pati ndikim të madh në opinionin publik, duke ngjallur shumë reagime, në kuptim edhe të ngritjes së vetëdijes shoqërore kundër racizmit dhe gjuhës së urrejtjes mbi baza etnike. Ekipi profesional i Platformës ka hartuar një raport profesional lidhur me këtë rast. Rasti ka qenë publik dhe është raportuar në vitin 2025.

26. Dy (2) raste të diskriminimit nga institucioni privat shëndetësor

Lloji i diskriminimit: Diskriminimi në punësim

Në muajin maj dhe qershor 2025³⁹ janë paraqitur dy (2) raste që kanë të bëjnë me diskriminim në punësim, respektivisht në sektorin privat shëndetësor.

Rasti 1:

Ankuesi është qytetar nga Prizreni dhe pjesëtar i komunitetit rom, me kualifikim në fushën e mjekësisë. Ky person kishte punuar në një institucion shëndetësor privat për më shumë se dhjetë (10) ditë provuese. Sipas provave të siguruara nga ekipi profesional i platformës kombëtare, i njëjti kishte kryer të gjitha detyrat profesionale të caktuara nga institucioni gjatë periudhës së punës. Në momentin kur i punësuar i priste që të njëjtit t'i ofrohej kontrata e punësimit, ai ishte lajmëruar, befasisht dhe në mënyrë arbitrare, që nuk do të vazhdonte, respektivisht i ishte kërkuar që të largohet nga puna dhe institucioni pa i dhënë ndonjë arsyetim. Nga dyshimet në bazë të bisedës, pretendimi ka qenë që kjo ishte bërë për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe ngjyrës së lëkurës. Rasti është trajtuar nga ekipi profesional i Platformës kombëtare, si dhe janë realizuar edhe takime me ankuesin. Ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar me institucionin privat shëndetësor dhe ka marrë arsyetimin dhe sqarimin nga ky institucion, ku personeli është distancuar nga veprimet diskriminuese dhe ka shprehur mbështetjen për punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Rasti konsiderohet i adresuar.

Rasti 2:

I njëjti person kishte aplikuar për punësim, bazuar në thirrjen publike nga një institucion privat shëndetësor në komunën e Prizrenit. Sipas komunikimeve që ka pasur personi (ankuesi) me institucionin shëndetësor, të njëjtit e kanë njoftuar se ai është pranuar në punë, por i është thënë që për momentin institucioni nuk posedon licencë dhe se do të njoftohej me kohë pas licencimit. Ankuesi pohon se edhe pas kontakteve, ky njoftim nuk kishte ndodhur asnjëherë. Ndërkohë, ankuesi kishte kuptuar që në atë institucion shëndetësor ishin punësuar disa persona të tjerë. Ekipi profesional i Platformës kombëtare ka kontaktuar me institucionin privat shëndetësor dhe ka marrë sqarimin nga i njëjti institucion se procedurat janë zhvilluar në bazë të meritokracisë dhe pa diskriminim. Institucioni është shprehur i hapur për mbështetjen e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë rom dhe ashkali. Rasti konsiderohet i adresuar, pas përgjigjes nga institucioni privat.

³⁸ Rasti ka ndodhur në Prill 2025. <https://gazetablic.com/arrestohet-i-dyshuari-per-sulm-ndaj-futbollistit-belgin-jashari/>, qasur me 01.12.2025.

³⁹ Ankues në këtë rast ka qenë personi i diskriminuar.

27. Rasti i sulmit mbi baza etnike

Lloji i diskriminimit: *Diskriminimi me vepër penale*

Rasti është raportuar në platformë në muajin qershor të vitit 2025, si dhe ka të bëjë me sulmin fizik ndaj një pjesëtari (të ri) të komunitetit rom në Prizren. Rasti është raportuar nga një aktivist i shoqërisë civile në komunën e Prizrenit.⁴⁰ Ekipi profesional i Platformës ka trajtuar rastin dhe ka paraqitur raport profesional, e po ashtu është takuar edhe me raportuesin. Pas hartimit të raportit profesional, në emër të platformës dhe grupit teknik i është adresuar një letër Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, e cila ka marrë përgjigje brenda 24 orëve. Rasti konsiderohet i adresuar. Rasti është raportuar në vitin 2025.

28. Dy (2) Rastet e martesave të hershme të parandaluara

Lloji i diskriminimit: *Nuk ka diskriminim*



Rasti 1:

Rasti nuk ka pasur të bëjë me diskriminim direkt, por me një tentim për martesë të hershme të një vajze nga radhët e komunitetit rom. Vajzës është tentuar t'i imponohet një martesë, pasi që e njëjta pa dëshirën e saj ishte marrë nga një djalë 20 vjeçar. Rasti është raportuar nga personat e tretë, ndërsa zgjidhjen e rastit e kanë ndihmuar edhe pjesëtarët e shoqërisë civile. Personat janë intervistuar nga Policia e Kosovës dhe martesat e hershme është parandaluar. Ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar edhe me Zyrën përkatëse për mbrojtjen e viktimave, në mënyrë që të gjenden mekanizma alternativë të cilat do të mundësonin parandalimin e martesës së hershme.



Rasti 2:

Rasti tjetër ka ndodhur në komunën e Mitrovicës, respektivisht në lagjen "Adem Voca". Këtu bëhet fjalë për një rast të raportuar nga një palë e tretë dhe jo në mënyrë anonime, e cila pohon se një vajze 17 vjeçare të komunitetit rom po i imponohet martesat nga babai i saj. Ekipi i Platformës ka kontaktuar me Qendrën për Punës Sociale dhe Policinë e Kosovës. Babai i vajzës është intervistuar nga Policia e Kosovës dhe rrjedhimisht martesat është parandaluar.

29. Rasti i diskriminimit në punësim nga sektori privat

Lloji i diskriminimit: *Diskriminimi në punësim*

Rasti⁴¹ nuk është raportuar në mënyrë anonime. Rrethanat e rastit kanë të bëjnë me diskriminimin e supozuar në sektorin privat për shkak të punësimit. Rasti ka ndodhur në komunën e Rahovecit, në një kompani private. Ankuesja femër pretendon që i është bërë padrejtësi në punësim vetëm pse i takon komunitetit (pa përmendur komunitetin). Në përshkrimin e rastit, ankuesja kishte pohuar se ka edhe prova. Megjithatë, edhe përkundër kontaktit të ekipit të Platformës, ankuesja nuk i dorëzoi asnjëherë provat që pretendonte t'i kishte. Ekipi ka kontaktuar me kompaninë në fjalë dhe ka marrë përgjigje pozitive, si dhe një arsyetim, se ankuesja nuk i kishte plotësuar krejtësisht kushtet. Rasti konsiderohet i adresuar, por edhe mund të theksohet se këtë rast e veçon fakti se pala e dëmtuar e kishte raportuar më shumë se një vit e gjysmë pasi kishte ndodhur ngjarja. Duhet theksuar që përkundër faktit se ekipi i Platformës ka kontaktuar disa herë me raportuesin e rastit, si dhe që ajo

⁴⁰ Rasti në fjalë është raportuar nga F.M.

⁴¹ Rasti i raportuar në mars të vitit 2025.



fillimisht kishte pohuar se posedon prova, e njëjta nuk i ka dorëzuar ato prova asnjëherë dhe nuk është përgjigjur. Rasti konsiderohet i adresuar, për faktin e pranimit të përgjigjes nga ana e personit juridik, nga sektori privat. Rasti konsiderohet i adresuar. Rasti është raportuar në vitin 2025.

30. Dy (2) raste të gjuhës së urrejtjes

Lloji i diskriminimit: Gjuhë e urrejtjes

Rasti 1:

Në shkurt të vitit 2025 në Platformë është paraqitur një rast ku pretendohet për gjuhë të urrejtjes. Ajo që duhet të theksohet është fakti që rasti është paraqitur në mënyrë anonime. Pasi ka analizuar rastin, ekipi profesional i Platformës ka vlerësuar që rasti nuk ka të bëjë fare me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, e si rezultat i kësaj, rasti konsiderohet që nuk përbënte diskriminim, e as nuk kishte të bënte fare me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Rasti 2:

Në janar të vitit 2025, në Platformë është paraqitur një rast nga një person zyrtar në institucionet e Republikës së Kosovës. Rasti kishte të bënte me një emision televiziv të një figure publike, i cili ndër të tjera kishte përdorur shprehjen fyese **“si thesi i magjupes”**. Kjo shprehje ngjalli reagime dhe rasti është raportuar në Platformë. Ekipi profesional i Platformës e ka adresuar rastin, ndërsa personi që kishte përdorur shprehjen fyese ndaj komuniteteve rom dhe ashkali kishte kërkuar falje. Kështu, pasojat e shkaktuara ishin neutralizuar me reagimin e personit që kishte përdorur shprehjen përkatëse, si dhe atë përmes adresimit në platformë. Personi i cili kishte përdorur shprehjen fyese ndaj komuniteteve rom dhe ashkali kishte kërkuar falje publike dhe kishte dhënë sqarime.

31. Rasti i diskriminimit në arsim në Mitrovicën veriore

Lloji i diskriminimit: I paqartë dhe nuk mund të identifikohet

Rasti ishte raportuar⁴² nga një person i tretë, ku pretendohet që një person ishte larguar nga shkolla nga prindi i saj. Rasti ka ndodhur në komunën e Mitrovicës. Raportuesja pretendonte që një vajzë e komunitetit rom ishte larguar nga shkolla dhe të gjitha aktivitetet sportive dhe të tjera brenda shkollës. Ekipi i Platformës ka kërkuar informacione shtesë nga raportuesja dhe të njëjtat u dorëzuan më 19.06.2025. Më pas ekipi i platformës informoi Qendrën për Punë Sociale në Mitrovicë, si dhe lajmëroi organet kompetente, respektivisht Policinë. Reagimi i Policisë erdhi menjëherë, duke parandaluar largimin e vajzës nga shkolla, ndërsa vajza është rikthyer në mësim dhe aktivitete të tjera shkollore.

32. Rasti i diskriminimit përmes tejzgjatjes së procedurës

Lloji i diskriminimit: nuk ka diskriminim të identifikuar

Rasti ishte raportuar⁴³ nga një aktivist i shoqërisë civile në Prizren. Rasti ka të bëjë me një çështje, e cila kishte kaluar në procedurë penale dhe që kishte pasur për pasojë vdekjen e një pjesëtari me nevoja të veçanta nga komuniteti rom. Raportuesi kishte shprehur shqetësimin për trajtimin jo të duhur të rastit nga organet shtetërore dhe gjykatat. Ekipi i Platformës kishte trajtuar rastin, duke bërë hulumtim dhe mbledhje të fakteve për këtë rast. Përfundimi ishte që kryerësi i veprës penale, person nga komuniteti

⁴² Rast i regjistruar në Platformën Kombëtare më 16 maj 2025.

⁴³ Rasti u raportua në muajin qershor 2025.

shumicë, ishte dënuar me vendim të formës së prerë, si dhe që rasti kishte përfunduar në procedurë penale. Po ashtu, ekipi i Platformës kishte analizuar rastin edhe në kontekstin e procedurës civile, respektivisht dëmshpërblimit eventuale të familjes së të ndjerit. Raportuesi është udhëzuar dhe është ndihmuar që rastin ta adresojë tek Avokati i Popullit si institucion kompetent që mundësi që *ex-officio* të ndërhyjë në procedurat gjyqësore të cilat mund të zgjasin përtej një kohe të arsyeshme. Rasti konsiderohet i adresuar nga ana e platformës.

33. Rasti i diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në arsim

Lloji i diskriminimit: *Diskriminimi në arsim dhe gjuhë e urrejtjes*

Rasti⁴⁴ ka ndodhur në komunën e Istogut dhe është raportuar nga një aktiviste e shoqërisë civile dhe mediave. Diskriminimi drejtohet ndaj komunitetit egjiptian në këtë komunë dhe ka të bëjë me bullizimin e fëmijëve në një shkollë publike në këtë komunë. Në rastin konkret, bëhet fjalë për bullizimin e pesë (5) fëmijëve të një familjeje, ku dyshohet që ky bullizim ka ardhur si pasojë e prejardhjes etnike të nxënësve. Bullizimi i vazhdueshëm kishte çuar edhe tek një incident, ku sipas raportueses ka qenë i përfshirë edhe një mësimsdhënë. Si rezultat i kësaj, fëmijët ishin larguar nga shkolla. Rasti është adresuar nga platforma, ndërsa ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar me Drejtorinë e Arsimit në komunën e Istogut, si dhe me Kryetarin e Komunës. Po ashtu, është lajmëruar edhe Zyra për komunitete në këtë komunë. Në një afat prej pesë (5) ditësh pas adresimit të rastit nga Grupi Teknik, rasti ishte adresuar nga Kryetari i komunës, ndërsa fëmijët ishin kthyer në shkollë.

34. Rasti i diskriminimit përmes uzurpimit të pronës

Lloji i diskriminimit: *Diskriminim me shkeljen e të drejtës në pronë*

Rasti⁴⁵ ka ndodhur në komunën e Istogut dhe është raportuar nga një palë e tretë. Rasti ka të bëjë me pretendimin që për 16 vite me radhë, Komuna e Istogut kishte uzurpuar pronën private të pjesëtarëve të komunitetit egjiptian, të cilët janë me banim në Zvicër, me arsyetimin e zgjerimit të varrezave. Pala pretendon që kjo pronë është uzurpuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, edhe mbi baza etnike, duke e ditur që pronarë janë pjesëtarët e komunitetit egjiptian. Ekipi i Platformës ka kërkuar më shumë informacione nga raportuesi, por nuk i ka pranuar ato. Në këto kushte, me informatat nga përshkrimi i rastit, i është drejtuar Kryetarit të komunës së Istogut, si dhe ka marrë përgjigje nga i njëjti se rasti do të verifikohet dhe adresohet. Andaj, rasti konsiderohet i adresuar. Nga ana e komunës së Istogut akoma nuk është marrë ndonjë vendim final në lidhje me rastin.

35. Rasti i diskriminimit të fëmijës nga organi shtetëror

Lloji i diskriminimit: *Diskriminim dhe shkelje e të drejtës së fëmijës*

Rasti⁴⁶ është raportuar nga një shtetase e komunitetit shumicë që ngre dyshime për shkelje të së drejtës së fëmijës së saj, si dhe është paraqitur në Komunën e Istogut. Sipas përshkrimit të rastit, Qendra për Punë Sociale në Istog nuk i ka lëshuar fëmijës së raportueses një pëlqim përmes të cilës ajo do të aplikonte për dokumentet e udhëtimit. Raportuesja pohon se ka kujdestarinë për vajzën e saj, me vendim të Gjykatës Kompetente dhe përkundër kësaj, Qendra për Punë Sociale në komunën e Istogut i ka mohuar nxjerrjen e dokumentit/dëshmisë së nevojshme, për të aplikuar për dokumente të udhëtimit, e që kërkohet me Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 01/2024 për Procedurat e pajisjes me pasaportë dhe dokument të udhëtimit për kthim. Ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar me raportuesen, ndërsa rasti është proceduar tek Avokati i Popullit për trajtimin e tij. Rasti konsiderohet i adresuar, edhe pse nuk ka qenë ekskluzivisht në mandatin e Platformës.

⁴⁴Rasti u raportua në muajin gusht 2025.

⁴⁵Rasti u raportua në muajin shtator 2025.

⁴⁶Rasti i raportuar në gusht 2025.

36. Tri (3) raste të diskriminimit në Gjakovë

Lloji i diskriminimit: Diskriminim me vepër penale

Rastet janë të natyrës së njëjtë dhe kanë të bëjnë me sulme dhe prishje të rendit dhe qetësisë publike. Raportuesi i rasteve është anonim. Rastet kanë ndodhur në komunën e Gjakovës. Në momentin e paraqitjes së tyre, ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, i cili i është përgjigjur me shkresë Grupit Teknik dhe Platformës se është bërë arrestimi i personave të dyshuar dhe se rasti në aspektin procedural është duke u trajtuar si lëndim i lehtë trupor.⁴⁷ Rastet janë raportuar në nëntor të vitit 2025.

34. Rasti i gjuhës diskriminuese të përdorur në një reality show:

Lloji: Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi medial

Përshkrimi: Një raport anonim është bërë në Platformë në lidhje me gjuhën diskriminuese të përdorur ndaj komuniteteve në një *reality show*. Gjuha në mënyrë specifike u referohej atyre si "Magjup". Platforma mori masa duke trajtuar rastin dhe duke nënvizuar pasojat e shkaktuara nga video diskriminuese. Produksioni është përgjigjur duke hequr videon dhe çështja tashmë konsiderohet e mbyllur. Rasti është raportuar në vitin 2022.

35. Rasti i diskriminimit i raportuar ndaj Komunës së Klinës:

Lloji: Diskriminim i pretenduar nga një institucion publik

Përshkrimi: Një raport anonim për diskriminim është bërë ndaj Komunës së Klinës dhe është raportuar në Platformë. Platforma e ka adresuar rastin dhe ka marrë përgjigje nga Komuna e Klinës, ku është kuptuar se ky rast nuk ka të bëjë me diskriminim. Rasti është raportuar në vitin 2022.

36. Rasti i kallëzimit anonim të diskriminimit ndaj kompanisë së transportit të udhëtarëve:

Lloji: Diskriminim i pretenduar nga një kompani private

Përshkrimi: Një kallëzim anonim i diskriminimit është bërë ndaj një kompanie të transportit të udhëtarëve dhe është raportuar në Platformë. Ndonëse nuk dihet se cila është pala e diskriminuar, Platforma e ka trajtuar këtë rast. Ministria kompetente për infrastrukturën (MMPHI) i është përgjigjur Platformës lidhur me rastin. Detajet e përgjigjes dhe rezultati nuk jepen, por përmendet se rasti konsiderohet i mbyllur. Rasti është raportuar në vitin 2022.

37. Rasti anonim i raportuar në Pejë:

Lloji: Diskriminim i pakualifikuar

Përshkrimi: Në Pejë është bërë një raport anonim, i cili ka dhënë vetëm një fjalë pa ndonjë informacion shtesë. Për shkak të mungesës së detajeve, dhe kontakteve platforma nuk ka mundur të trajtojë rastin. Rasti është raportuar në vitin 2022.

38. Rast anonim i raportuar në Fushë-Kosovë ku përmendet "racizmi":

Lloji: Racizëm i supozuar

Përshkrimi: Një raport anonim është bërë në Fushë-Kosovë, ku është përmendur fjala "racizëm" pa asnjë informacion të mëtejshëm. Platforma nuk ishte në gjendje të trajtonte çështjen për shkak të mungesës së detajeve. Rasti është raportuar në vitin 2022.

⁴⁷ Përgjigja zyrtare e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, më 30 tetor 2025.



39. Rast anonim i diskriminimit i raportuar në Pejë:

Lloji: Diskriminim i pakualifikuar

Përshkrimi: Një rast tjetër i diskriminimit është raportuar në mënyrë anonime në Pejë, pa asnjë informacion përveç një fjale. Platforma nuk mundi ta trajtonte rastin për mungesë detajesh. Rasti është raportuar në vitin 2022.

40. Rast anonim i diskriminimit i raportuar në një biznes privat në Fushë-Kosovë:

Lloji: Diskriminim i panjohur në një biznes privat

Përshkrimi: Një rast i diskriminimit është raportuar në një biznes privat në Fushë-Kosovë, me vetëm një fjali të dhënë dhe asnjë informacion shtesë. Platforma nuk ishte në gjendje të trajtonte çështjen për shkak të mungesës së detajeve. Rasti është raportuar në vitin 2022.

41. Rasti anonim i diskriminimit drejtuar kryeministrit të Kosovës:

Lloji: Diskriminim i panjohur drejtuar Kryeministrit

Përshkrimi: Një person anonim i ka shkruar një letër të hapur Kryeministrit të Kosovës lidhur me diskriminimin. Megjithatë, rasti nuk ka mundur të trajtohet për shkak të mungesës së informacionit, anonimitetit dhe mënyrës së raportimit. Rasti është raportuar në vitin 2022

42. Rasti anonim i diskriminimit ndaj Qeverisë së Kosovës:

Lloji: Diskriminim i supozuar nga qeveria

Përshkrimi: Një raport anonim pretendonte se Qeveria e Kosovës mohon ekzistencën e egjiptianëve të Kosovës. Rastit i mungojnë informacionet thelbësore dhe personi mbetet anonim. Rasti është raportuar në vitin 2022.

43. Rasti anonim i diskriminimit i raportuar në lokalitetin "Retro" në Gjakovë:

Lloji: Diskriminim i pakualifikuar në një biznes

Përshkrimi: Një person anonim ka raportuar një rast të diskriminimit në biznesin afarist "Retro" në Gjakovë. Asnjë informacion nuk është dhënë, ndërsa pala e prekur nuk ka dhënë asnjë informacion kontakti, e as shpjegime të mëtejshme për diskriminimin. Rasti është raportuar në vitin 2023.

44. Rasti anonim i diskriminimit në një institucion shëndetësor në Fushë-Kosovë:

Lloji: Diskriminim i pretenduar në një institucion shëndetësor

Përshkrimi: Një person pretendon se ka përjetuar diskriminim në një institucion shëndetësor në Fushë-Kosovë. Megjithatë, personi që ka raportuar rastin mbetet anonim dhe Platforma nuk ka mundur ta trajtojë rastin për shkak të mungesës së informacionit dhe provave bazë. Rasti është raportuar në vitin 2023.

45. Rasti i diskriminimit i raportuar nga një pjesëtar i komunitetit rom (Rasti 1):

Lloji: Pretendim i pabazuar për diskriminim

Përshkrimi: Një pjesëtar i komunitetit rom raportoi një rast të diskriminimit në platformë, duke ofruar disa detaje se si ka ndodhur incidenti. Ekipi i Platformës e trajtoi rastin dhe u takua me palën përkatëse për të diskutuar çështjen. Megjithatë, pavarësisht diskutimeve, pala nuk arriti të sigurojë prova konkrete të diskriminimit apo të identifikojë subjektet përgjegjëse për të. Rasti mbetet i pazgjidhur për shkak të mungesës së provave mbështetëse. Rasti është raportuar në vitin 2022.

46. Rasti i diskriminimit i raportuar nga i njëjti pjesëtar i komunitetit rom (Rasti 2):

Lloji: Pretendim i pabazuar për diskriminim

Përshkrimi: I njëjti individ nga komuniteti rom raportoi një rast të veçantë të diskriminimit në Platformë. Ky rast dallon nga ai i mëparshmi për nga natyra e tij. Përsëri, ekipi i Platformës u angazhua me palën dhe diskutoi rastin, por pala nuk arriti të sigurojë prova konkrete apo të identifikojë subjektet e përfshira në diskriminimin e pretenduar. Rasti mbetet i pazgjidhur për shkak të mungesës së provave mbështetëse. Rasti është raportuar në vitin 2022.

47. Rast anonim për diskriminimin nga persona fizikë:

Lloji: Diskriminimi i pretenduar nga personat fizikë

Përshkrimi: Një person, që ka dashur të mbetet anonim, si dhe e cila punon në KFOR, pretendon që është duke u diskriminuar nga disa kolege të saj të kombësisë shqiptare. Platforma nuk ka arritur të ndërmarrë veprime në mungesë të informatave tjera dhe kontakteve të raportueses. Rasti është raportuar në vitin 2023.

48. Rasti i gjuhës së urrejtjes në Obiliq:

Lloji: Diskriminimi i pretenduar/gjuhë e urrejtjes

Përshkrimi: Një person anonim raporton që është ushtruar gjuhë e urrejtjes në Obiliq. Megjithatë në Platformë nuk janë raportuar as të dhëna dhe as detaje tjera që do të ndihmonin në adresimin e rasteve nga platforma. Rasti është raportuar në vitin 2023.

49. Rasti që adreson çështjet e Platformës:

Lloji: Nuk ka diskriminim

Përshkrimi: Një person i komunitetit rom raporton dhe kërkon që Platforma për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të përkthehet në gjuhën rome. Ekipi i Platformës i është përgjigjur personit lidhur me çështjen e ngritur. Rasti është raportuar në vitin 2023.

50. Rast i mohimit të regjistrimit në një "klub fitnesi":

Lloji: Diskriminim në sektorin privat

Përshkrimi: Një person anonim raporton që i është mohuar regjistrimi në një klub fitnesi në komunën e Obiliqit, vetëm pse ai i përket komunitetit rom. Platforma nuk ka pasur asnjë të dhënë dhe nuk ka mundur ta kontaktojë ankuesin/en anonim/e, e po ashtu, nuk është paraqitur ndonjë dëshmi në databazë që vërteton çështjen e raportuar. Rasti është raportuar në vitin 2023.

51. Dy raste tjera të raportuara në mënyrë anonime dhe pa objekt

Lloji: Nuk identifikohet

Përshkrimi: Dy raste tjera, të raportuara nga persona anonimë, kanë pasur të bëjnë me vetëm nga një fjalë në Platformë, respektivisht fjalën "diskriminim" dhe fjalën "Bullying". Nuk ka pasur asnjë të dhënë tjetër, ndërsa platforma nuk ka mundur t'i kontaktojë raportuesit. Rasti është raportuar në vitin 2023.

52. Diskriminimi në sferën e artit muzikor

Lloji: Diskriminim individual

Përshkrimi: Një person anonim raporton që në një këngë, ku marrin pjesë dy këngëtarë shqiptarë dhe një i komunitetit rom, e cila është publikuar edhe në kanalën *Youtube*, nuk përmendet emri i pjesëtarit të komunitetit rom. Platforma nuk ka mundur të vazhdojë me procedurat e mëtejme për shkak të mungesës së informacioneve dhe identitetit të raportuesit. Rasti është raportuar në vitin 2023.



53. Gjuha e urrejtjes e shkaktuar nga një mjeke

Lloji: Diskriminim i supozuar/gjuhë e urrejtjes

Përshkrimi: Një ankues/e anonim pretendon që një mjeke nga komuna e Gjilanit, në rrjetin social Facebook, ka përdorur shprehje raciste në drejtim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke përdorur termin “zezak”. Pala raportuese nuk ka ofruar prova lidhur me këtë rast si dhe për identitetin e tij/saj. Rasti është raportuar në vitin 2023.

54. Diskriminimi nga një biznes privat në Gjakovë

Lloji: Diskriminim i supozuar

Përshkrimi: Një raportues/e anonim thekson që i përket komunitetit egjiptian, është larguar nga një lokal vetëm pse i përket komunitetit përkatës. Megjithatë, Platforma nuk ka asnjë informacion se ku dhe si ka ndodhur rasti, ndërsa platforma nuk është e njohur me identitetin e raportuesit/es. Rasti është raportuar në vitin 2023.

55. Rasti i raportuar nga një shtetas i komunitetit shumicë shqiptar në Platformë

Diskriminim nga marrëdhënia e punës

Me datë 11 shtator 2024, Platforma kishte pranuar një rast që kishte të bënte me largimin nga puna të një shtetasi të Republikës së Kosovës⁴⁸, respektivisht nga Shërbimi Civil i Kosovës. Duke besuar në punën e Platformës, raportuesi është ankuar për trajtimin e rastit të tij nga mekanizmat kompetentë për zbatimin e ligjeve në fuqi për Shërbimin Civil të Kosovës.

4.2. Viti 2025, vit i parandalimit të diskriminimit përmes rasteve të raportuara në Platformë, si dhe sfidat e identifikuara

Secili vit ka karakteristikën e tij, përkitazi me rastet e raportuara në platformë. Siç u theksua më sipër, viti 2025 shënon 17 raste të raportuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe persona të tretë që janë qasur në Platformë. Bazuar në cilësinë e rasteve të raportuara, përmbajtjen dhe mënyrën e veprimit, ka disa karakteristika që identifikojnë vitin 2025 dhe punën e Platformës.

Ndër vite, Platforma ka pasur ngritje dhe avancim falë punës dhe mbështetjes së partnerëve, ekspertizës së ofruar dhe bashkëpunimit me palë, ndërsa viti 2025 karakterizohet nga këto aspekte:

1. Në të gjitha rastet, falë reagimit të Platformës dhe reagimit institucional, është përforcuar parandalimi i diskriminimit⁴⁹;
2. Ka pasur komunikim të nivelit të lartë dhe efikas me të gjitha palët, por edhe përgjigje dhe kontakte të drejtpërdrejta dhe takime të ekipit të Platformës;
3. Numri i rasteve të paraqitura anonimisht ka qenë i ulët, respektivisht 1 rast, që shfaq rritjen e besimit në Platformë dhe në institucione;
4. Të gjitha rastet e vitit 2025 janë adresuar dhe kanë marrë përgjigje nga institucionet;
5. Numri i rasteve të vitit 2025 ka qenë më i madh se në vitin 2024 për 25%;
6. Palët raportuese në Platformë kanë shprehur besimin publik për punën dhe adresimin e rasteve si dhe suksesin e tyre;⁵⁰

⁴⁸ Shtetasi me inicialet B.H.

⁴⁹ Përgjigjet e marra nga: Prokuroritë Themelore në Prizren dhe Gjakovë; Përgjigjet e pranuar nga sektori privat shëndetësor dhe personat e tjerë juridikë; Veprimet publike të personave në korrigjim të shprehjeve të tyre fyese; Veprimet e ndërmarra nga Policia në rastet e adresuara të martesave të hershme; përgjigjet e tjera nga persona juridikë privatë. Të gjitha këto veprime janë të përshkruara në rastet e mësipërme.

⁵⁰ Postimi dhe komenti në rrjete sociale i palës të cilit i është ofruar zgjidhja e rastit dhe adresimi, A.P (rast i përshkruar në këtë raport), nëntor 2025.

7. Platforma ka arritur të sigurojë edhe përgjigje nga ana e sektorit privat, gjë që flet edhe vetëdijesimin e gjerë, si dhe mënyrën se si është pranuar Platforma tek institucionet, përfshirë edhe ato të sektorit privat.

Përveç arritjeve të shënuara gjatë vitit 2025, janë identifikuar edhe sfida të ndryshme të cilat kanë dalë në pah përmes komunikimit me palë të ndryshme. Në këtë kontekst, vlen të përmendet një kontakt i realizuar më 29 shtator 2025, me një palë që pretendonte se ishte viktimë e diskriminimit në fushën e punësimit në sektorin publik komunal. Pala në fjalë pretendonte se i përmbushte të gjitha kriteret e përcaktuara për punësim në sektorin e arsimit, por se ishte diskriminuar gjatë procesit të përzgjedhjes.⁵¹ Pavarësisht komunikimit të vazhdueshëm të ekipit të Platformës me palën, adresimit fillestar të rastit dhe ofrimit të këshillave profesionale për hapat e mëtejshme, rasti nuk është regjistruar zyrtarisht në Platformë, duke mbetur në nivel të raportimit të tentuar. Arsyet konkrete për mos-raportimin përfundimtar të rastit nuk janë të njohura për Platformën. Megjithatë, duke marrë parasysh komunikimin e vazhdueshëm me palën e dëmtuar, mund të supozohet se ka pasur faktorë të ndryshëm që kanë ndikuar në vendimin e palës për të mos proceduar më tej me raportimin formal të rastit.

Përgjithësisht, përgjatë gjithë punës së realizuar në Platformë përgjatë 3.5 viteve, posaçërisht gjatë vitit 2025, janë identifikuar disa sfida të ndryshme, përmbajtjesore e teknike. Këto sfida mund të përmblihen si në vijim:

- 1.** Vazhdon raportimi i rasteve anonime, edhe pse në vitet 2024 dhe 2025 në shifra minimale;
- 2.** Palët raportuese këtë e bëjnë duke mos dërguar prova, e zakonisht edhe pas kontaktit nga ekipi i Platformës, nuk dërgojnë prova;
- 3.** Hezitimi për të raportuar, pavarësisht punës profesionale të ZQM/ZKM, TDhK, Grupit Teknik dhe ekipit të Platformës;
- 4.** Kur e raportojnë rastin dhe nuk lënë kontaktin e tyre, palët zakonisht nuk kthehen mbrapa për të shikuar se çfarë ka ndodhur me rastin e tyre, ose të dërgojnë prova;
- 5.** Ka nevojë të rritet vetëdijesimi për mënyrën e raportimit, për shkak se shumë raste nuk mund të raportohen për shkak të pamundësive teknike të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo sfidë është identifikuar gjatë takimeve me grupe fokusi në vitin 2025;
- 6.** Zakonisht, kur një rast raportohet dhe adresohet nga Platforma, institucionet si Avokati i Popullit, Prokuroria dhe Gjykatat me vështirësi japin informacion për shkak të procedurave anonime, andaj edhe dhënia e informacioneve kthyesë për gjendjen e rastit duhet të trajtohet si sfidë, në kuptimin e raportimit për statusin e rasteve të platformës.

⁵¹ Rasti kishte ndodhur në Komunën e Prizrenit, ndërsa përfshin një pjesëtar të komunitetit rom.



5. TË DREJTAT QË I JANË SHKELUR KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN, PËRMES RASTEVE TË RAPORTUARA NË PLATFORMË

Në të gjitha rastet e adresuara (zgjidhura) nga platforma (33), përfshirë edhe në ato që janë në procedurë të trajtimit, janë shoqëruar edhe me shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Liritë dhe të drejtat e caktuara, në rastet e adresuara nga ana e Platformës, janë cenuar, ndërlidhur me veprimet e caktuara të autoriteteve publike.

Tabela vijuese pasqyron të drejtat që i janë cenuar pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian sipas përshkrimit të rasteve. Në kuadër të kësaj tablele nuk janë përfshirë rastet e pasqyruara në raport, të cilët nuk kanë rezultuar me diskriminim, për arsye të sqaruara më sipër.

Rasti sipas përshkrimit në këtë raport	E drejta e cenuar sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me bazë diskriminimin
Rasti i diskriminimit kolektiv ndaj komunitetit rom nga Obiliqi	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]
Rasti i diskriminimit nga Policia e Kosovës ndaj një pjesëtari të komunitetit rom	Neni 43 [Liria e Tubimit]
Rasti i diskriminimit ndaj një gruaje nga komuniteti rom:	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]
Rastet e mohimit të shtetësisë për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore	Neni 35 [Liria e Lëvizjes]
Rasti i diskriminimit të vazhdueshëm nga një person fizik, që ndikon në qasje në pronë:	E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]
Rasti i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit kolektiv i promovuar përmes rrjeteve sociale	N/A
Rasti i diskriminimit në arsimin e lartë	Neni 47 [E Drejta për Arsimin]
Rasti i diskriminimit të vazhdueshëm në punësim nga Ministria e Shëndetësisë	Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]
Rasti i gjuhës së urrejtjes me rastin e festimit të ditës së komunitetit egjiptian	N/A
Diskriminimi i 25 fëmijëve romë dhe ashkalinj nga komuna e Fushë-Kosovës, si dhe mohimi i të drejtës në arsim	Neni 47 [E Drejta për Arsimin]
Diskriminimi i fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në një shkollë në komunën e Prizrenit:	Neni 24 [Barazia para Ligjit] , Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

Diskriminimi i nxënësve nga një shkollë në komunën e Fushë-Kosovës	Neni 47 [E Drejta për Arsimin]
Diskriminimi i dy nxënësve me aftësi të kufizuara nga komuniteti rom,	Neni 47 [E Drejta për Arsimin]
Rasti i fëmijëve romë ëqë bredhin në rrugë, si dhe diskriminimi me mosveprim	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]
Ankesa ndaj kompanisë Pastrimi në Komunën e Lipjanit	N/A
Rasti i fëmijëve romë pa kujdes prindëror	Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]
Diskriminimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)	Neni 24 [Barazia para Ligjit]
Diskriminimi racor nga Policia e Kosovës	Neni 24 [Barazia para Ligjit]
Diskriminimi i raportuar nga një kompani private	N/A
Diskriminimi i komuniteteve rom dhe ashkali nga KEDS-i	Neni 24 [Barazia para Ligjit]
Diskriminimi i pjesëtarit të komunitetit ashkali, që për-bënte vepër penale	Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]
Rastet e raportuara për martesat e hershme	Neni 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes]
Rasti i diskriminimit publik të futbollistit B.J.	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]
Dy (2) raste të diskriminimit nga institucioni privat shëndetësor	Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]
Rasti i sulmit mbi baza etnike	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]
Rasti i diskriminimit në punësim nga sektori privat	Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]
Dy (2) raste të gjuhës së urrejtjes	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]
Rasti i diskriminimit në arsim në Mitrovicën veriore	Neni 47 [E Drejta për Arsimin]
Rasti i diskriminimit përmes tejzgjatjes së procedurës	Neni 24 [Barazia para Ligjit], E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm,
Rasti i diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në arsim	Neni 47 [E Drejta për Arsimin]
Rasti i diskriminimit përmes uzurpimit të pronës	Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]
Rasti i diskriminimit të fëmijës nga organi shtetëror	Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]
Tre (3) raste të diskriminimit etnik me vepër penale, nga viti 2025	Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Nga të gjitha rastet e trajtuara nga Platforma, në kuptim të shkëljes së të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, rezultojnë që më së shumti është shkelur e drejta për arsim. Respektivisht, për nga numri i rasteve që janë trajtuar nga Platforma, në raport me të drejtat e shkelura, statistikat janë si në vijim:

- 1.** E drejta për arsim është shkelur në 7 raste;
- 2.** Barazia para ligjit është shkelur në 5 raste;
- 3.** Dinjiteti i njeriut është shkelur në 6 raste;
- 4.** Mbrojtja e pronës është shkelur në 3 raste;
- 5.** Të drejtat e fëmijës në 1 rast;
- 6.** Në disa raste nuk janë identifikuar shkelje të të drejtave të njeriut, për shkak se diskriminimi ka ndodhur nga sektori privat.



6. NDIKIMI I PLATFORMËS KOMBËTARE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË LUFTIMIN E DISKRIMINIMET

Siç është potencuar më sipër, përgjatë 3.5 viteve të punës së saj, që nga themelimi i platformës, krahas rasteve tjera të raportuara në të, Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, kanë trajtuar edhe 7 raste të cilat ishin paraqitur si vijon: 5 pranë Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit (2019), si dhe 2 pranë Grupit Teknik (2021), para se të bëhej funksionalizimi i Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto raste janë regjistruar në databazën e platformës dhe janë duke u monitoruar vazhdimisht nga platforma, deri në përfundimin e tyre. Po ashtu, këto raste janë trajtuar në tërësinë e statistikave të nxjerra në këtë raport, pasi që kanë qenë të regjistruara manualisht në databazën e platformës, pas lansimit të saj në vitin 2022.

Pas raportimit të secilit rast. Ekipi profesional i Platformës⁵² ka ndjekur një metodologji të punës dhe veprimeve vijuese, përfshi: analizimi i fakteve; komunikimi me palën/palët raportuese; mbledhja dhe shqyrtimi i provave përkatëse të dorëzuara nga pala/palët raportuese; takimet me palët; përgatitja e raportit analitik për rastin; përgatitja e shkresave për adresimin e rastit në institucionet përgjegjëse sipas LMD-së (Avokati i Popullit, institucionet lokale/administrative; institucionet qendrore; Prokurorinë e Shtetit; Policinë e Kosovës dhe Gjykatat kompetente apo edhe institucionet e caktuara private, respektivisht personat juridikë privatë); monitorimin e rastit sipas nevojës, në të gjitha fazat e përcjelljes.

Përgjatë punës së ekipit të platformës, rastet anonime janë trajtuar me raporte për secilin rast, por pa pasur mundësi të adresohen, për shkak të mungesës së subjektit që është diskriminuar si dhe informacioneve (dëshmi) lidhur me diskriminimin eventual. Në anën tjetër, në disa raste raportuesit nuk janë përgjigjur që të sjellin fakte dhe prova që dëshmojnë çështjet e ngritura në raportim dhe si rezultat rasti nuk ka pasur mundësi të adresohet, si pasojë e vullnetit të palëve, pavarësisht takimeve të realizuara.⁵³ Megjithatë, në krahasim me vitet e tjera, në vitin 2025, ka qenë vetëm një rast anonim dhe është vërejtur edhe gatishmëria e palëve që kanë raportuar për të kthyer përgjigje dhe për të ofruar informacione shtesë.⁵⁴ Po ashtu, në vetëm një rast gjatë vitit 2025, pala nuk është kthyer mbrapa për të dërguar prova shtesë të cilët pretendonte se i kishte.⁵⁵

⁵² Ekipi profesional i platformës përbëhet nga: zyrtarët e Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; eksperti juridik; administratorja e platformës; persona përgjegjës të caktuar nga partnerët mbështetës në kuadër të projekteve, siç është TDhK.

⁵³ Rastet e tilla janë ato të parashtruara nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian: K.K. dhe L.Q.

⁵⁴ Kjo vlen për të gjitha rastet e raportuara në vitin 2025, në krahasim me rastet e tjera.

⁵⁵ Rasti i raportuar në komunën e Rahovecit, diskriminim në punësim nga sektori privat; raportim i bërë në janar të vitit 2025.

Platforma përgjatë 3.5 viteve të punës së saj nga momenti i lansimit ka arritur të shërbejë si dritare e rëndësishme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të mbrojtjes nga diskriminimi. Për një (1) vit të punës së saj (qershor 2022-qershor 2023), platforma ka arritur të ketë 9976 vizitorë⁵⁶, indikator ky që tregon shtrirjen e Platformës brenda komuniteteve respektive. Që nga lansimi i saj e deri më 1 dhjetor 2023, platforma ka shënuar tërësisht 15,296 vizitorë dhe në total 673 llogari. Deri më 1 dhjetor 2024, Platforma ka pasur edhe 6600 vizitorë më shumë se në periudhën paraprahe vjetore (1 dhjetor 2023), ndërkaq ka pasur 199 llogari aktive më pak.⁵⁷ Gjatë vitit 2025, në Platformë janë hapur 36 llogari dhe janë raportuar 17 raste, ndërsa janë qasur 1535 vizitorë. Në kuptim të numrit të vizitorëve, nga viti 2024 në krahasim me vitin 2025, edhe pse në vitin 2024, numri i vizitorëve në Platformë ka qenë më i madh, numri i rasteve të raportuara ka qenë më i vogël se në vitin 2025. Kjo tregon për një efikasitet më të madh të platformës, nisur nga proporcioni i numrit të vizitorëve dhe numrit të raportuesve.

Ndërkohë që për një vit të punës së saj (qershor 2021-qershor 2022) në platformë janë raportuar 23 raste në tërësi.⁵⁸ Ndërkaq, vetëm nga muaji qershor 2023 deri në muajin nëntor 2023, në distancë kohore prej pesë (5) muajsh, në platformë janë raportuar 16 raste të reja. Ky fakt nënkupton që në platformë, në periudhën korrik-nëntor 2023, janë raportuar mbi 70% të rasteve që ishin raportuar gjatë gjithë vitit, respektivisht qershor 2021-qershor 2022. Ky argument tregon për një rritje të dukshme të numrit të raportuesve në platformë, rritje të vetëdijesimit për rëndësinë e raportimit të rasteve, gjë që përfundimisht përbën vlerësim të punës së Platformës.

Përderisa në periudhën njëvjeçare të punës së Platformës, nga 23 raste të raportuara, 2 prej rasteve ishin zgjidhur deri në nëntor 2023⁵⁹, krahas rasteve të reja të paraqitura, 7 raste gjatë kësaj periudhe ishin zgjidhur në tërësi.

Po ashtu, numri i rasteve të reja deri më 31 dhjetor 2024, e që kanë përfunduar dhe janë trajtuar, u rrit në 18. Në anën tjetër, përderisa në njëvjetorin e punës së Platformës, nga 23 raste të raportuara, 10 prej tyre ishin në proces, në muajin nëntor 2023⁶⁰, nga 39 raste të raportuara, vetëm 9 prej rasteve ishin në pritje të procedurës së trajtimit pranë institucioneve kompetente sipas LMD-së. Gjendja ka ndryshuar për të mirë, deri më 31 dhjetor 2024, ku vetëm 7 raste të reja ishin në trajtim, kurse në vitin 2025 kjo shifër e përgjithshme është 8. Kjo tregon për rritje të efikasitetit dhe bashkëpunimit me institucione në adresimin e rasteve. Po ashtu, shembujt e suksesit në vitin 2024 tregojnë për rritje të numrit të rasteve të trajtuara, nga 7 në vitin 2023, në 18 në vitin 2024, raste këto që konsiderohen të jenë mbyllur me sukses, në kuptimin e adresimit.

Viti 2025 ka qenë edhe më i suksesshëm për sa i takon rritjes së numrit të rasteve të adresuara, duke arritur që të zgjidhen 16 raste të raportuara, pa përfshirë ato në të cilat nuk është identifikuar diskriminimi apo nuk janë dërguar prova nga palët. Numri i tërësishëm i rasteve të raportuara, përfshirë edhe këto të vitit 2025, u rrit në 33 raste. Rrjedhimisht, vetëm një rast mbeti i pa zgjidhur në vitin 2025, nga totali prej 17 rasteve që ishin raportuar.

⁵⁶ Shih Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, rom, ashkali dhe egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f. 6.

⁵⁷ Emaili konfirmues i administratorit të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, datë 14.12.2024.

⁵⁸ Po aty, f.6.

⁵⁹ Po aty, f.9.

⁶⁰ Po aty f.9.

Ndër vite, 2022, 2023, 2024 dhe 2025, Platforma në vazhdimësi ka shënuar rritje të numrit të rasteve të raportuara, respektivisht: në vitin 2022 janë raportuar 11 raste; në vitin 2023 janë raportuar 21 raste, në vitin 2024 janë raportuar 13 raste dhe në vitin 2025 janë raportuar 17 raste. Megjithatë, numri më i rritur në vitin 2023 është për shkakun se shumica e konsiderueshme e këtyre rasteve janë paraqitur në mënyrë anonime ose kanë qenë teknikisht të perealizueshme. Në anën tjetër, në vitin 2024, është regjistruar një rast anonim, kundrejt viteve të kaluara kur numri i raportimeve anonime ka qenë relativisht më i madh. Edhe në vitin 2025, numri i rasteve anonime ishte një (1). Në krahasim me të gjitha vitet, në vitin 2025 është rritur dukshëm numri i rasteve të adresuara dhe zgjidhura me sukses, ndërsa kjo dëshmon për efikasitetin e Platformës si dhe punën që ka bërë Grupi Teknik dhe ekipi profesional i Platformës në komunikimin e vazhdueshëm me palë si dhe rritjen e besimit tek palët raportuese.

Duke parë një efikasitet të tillë të zhvillimit të rasteve, atëherë mund të konstatojmë që Platforma ka luajtur një rol të rëndësishëm në luftimin e diskriminimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, përgjatë 3.5 viteve të ekzistimit dhe punës së saj.

7. PROMOVIMI I PLATFORMËS KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Përgjatë vitit 2024, ZQM/ZKM, së bashku me partnerët përkatës, ka ndërmarrë një sërë seancash informuese dhe trajnimeve për të drejtat e njeriut dhe promovimin e punës së platformës.

Sesionet informuese që kanë pasur për fokus edhe promovimin e punës së Platformës kombëtare, përgjatë 2024, janë si vijon, mes tjerash:

- Më 9 shtator 2024, u organizua një sesion informues me Zyrtarët për Mbrojtje nga Diskriminimi në nivel qendror, si dhe me Njësitë për të Drejtat e Njeriut në komunat e Republikës së Kosovës. Ky sesion u fokusua në mekanizmat për raportimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me theks të veçantë në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për këto komunitete. Aktiviteti u organizua nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit, me mbështetjen e *Terre des hommes* në Kosovë, *Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve*, dhe Fondacionit HEKS. Qëllimi i sesionit ishte ofrimi i një pasqyre të detajuar mbi funksionimin e Platformës Kombëtare dhe rolin e saj në mbrojtjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga diskriminimi. Gjatë sesionit, pjesëmarrësit u informuan mbi aspektet kushtetuese dhe ligjore të mbrojtjes nga diskriminimi, mekanizmat institucionalë për trajtimin e rasteve, si dhe mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstucional në këtë fushë. Gjithashtu, u organizua një sesion informues për Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, dedikuar drejtpërdrejt komuniteteve përfituese. Qëllimi i këtij sesioni ishte rritja e vetëdijes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbi rolin dhe funksionimin e platformës, si dhe mbi mënyrat e raportimit të rasteve të diskriminimit. Aktiviteti u organizua nga ZQM/ZKM, në bashkëpunim me organizatën *Advancing Together*.
- 18 nëntor 2024 - në Graçanicë është mbajtur sesioni informues mbi drejtat e njeriut dhe Platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- 22 nëntor 2024 - në Prishtinë është mbajtur trajnimi mbi Kornizën e Indikatorëve për monitorimin e zbatimit të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si lidhur identifikimin dhe raportimin mbi diskriminimin, përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes;
- 9 dhjetor 2024 - në Lipjan është mbajtur sesioni informues mbi drejtat e njeriut dhe platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- 16 dhjetor 2024 - në Gjakovë është mbajtur trajnimi mbi Kornizën e Indikatorëve për monitorimin e zbatimit të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe lidhur identifikimin dhe raportimin mbi diskriminimin, përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes.
- Më 26 nëntor 2024 - Samiti i Ballkanit Perëndimor Kundër Diskriminimit Racor – Forca në Diverzitet: Një Shoqëri pa Diskriminim Racor - u përqendrua, ndër të tjera, në vlerësimin e samiteve të mëparshme dhe ndikimin e tyre mbi politikat dhe praktikën për luftimin e diskriminimit racor, duke përfshirë reflektimin mbi sfidat dhe mësimet e nxjerra gjatë viteve. Qëllimi i Samitit ishte që të bashkojë vendet e Ballkanit

Perëndimor, qeveritë, shoqërisë civile, ekspertët e pavarur dhe individë nga komunitetet përkatëse, për të adresuar së bashku diskriminimin ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Fokus kryesor ishte identifikimi i hapave dhe veprimeve të nevojshme që qeveritë duhet të ndërmarrin, duke theksuar gjithashtu rolin e shoqërisë civile.

- Po ashtu, përgjatë vitit 2024 dhe 2025, janë organizuar edhe trajnime dhe sesione informuese për adresimin e anti-gjipsizmit, ku kanë marrë pjesë zyrtarë publikë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, psikologë, pedagogë shkollorë dhe mësimdhënës. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qenë të ngritet vetëdija dhe njohuritë e pjesëmarrësve mbi diskriminimin ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të fuqizohen kapacitetet e tyre për trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe të nxiten praktika të përfshirjes dhe barazisë. Gjatë këtyre aktiviteteve, Platforma është prezantuar dhe promovuar si mjet i rëndësishëm për raportimin dhe adresimin e rasteve të diskriminimit, duke e vënë atë në fokus të procesit të vetëdijesimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve përkatëse. Në total, gjatë vitit 2024, nga trajnimet për anti-gjipsizëm përfituan 192 pjesëmarrës, duke përfshirë përfaqësues të institucioneve publike, profesionistë të sistemit gjyqësor dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Ndërsa gjatë vitit 2025, numri i përfituesve nga këto trajnime arriti në 216 pjesëmarrës. Gjatë vitit 2024, në kuadër të angazhimit për mbrojtjen dhe fuqizimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë organizuar 50 sesione informuese në nivel lokal, me pjesëmarrjen e gjithsej 687 personave. Ndërsa në vitin 2025, janë realizuar 60 sesione informuese, duke përfshirë 1,298 pjesëmarrës. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi anti-gjipsizmin dhe të drejtat kundër diskriminimit në nivel lokal.

Në kuadër të takimeve informuese, përveç tjerash ka pasur edhe përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët janë njohur nga afër me punën e Platformës, sukseset, rastet e raportuara dhe avancimet të cilat janë shënuar në vitin 2025.

ZQM/ZKM, së bashku me partnerët siç është TDhK, ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera promovuese me qëllim të luftimit të diskriminimit, e rrjedhimisht edhe të promovimit të raportimit të rasteve të diskriminimit përmes Platformës Kombëtare. Më poshtë renditen disa nga këto aktivitete **përgjatë viteve 2024-2025**.

- Më 23 prill 2025, një nga aktivitetet kyçe në luftën kundër diskriminimit racor ishte edhe lansimi i raportit përmbledhës mbi punën e Platformës Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën 2022–2024. Ky raport ofroi një pasqyrë të detajuar të funksionimit të Platformës, duke prezantuar të dhëna mbi rastet e diskriminimit të raportuara nga qytetarët, mënyrën e trajtimit të tyre, si dhe ndërhyrjet dhe masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për adresimin e këtyre rasteve. Prezantimi i raportit shërbeu gjithashtu si instrument për rritjen e transparencës, përforcimin e llogaridhënies institucionale dhe inkurajimin e qytetarëve për të shfrytëzuar platformën si mekanizëm efektiv për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- Më datë 22 Maj 2025, në Qendrën e mësimin të rëndësishëm të menaxhimit nga TDhK në Prishtinë është mbajtur takim me pjesëtarët gra të komunitetit ashkali. Në këtë takim është shpjeguar roli i Platformës dhe bashkërisht me pjesëmarrëset janë diskutuar edhe rastet e diskriminimit dhe janë identifikuar raste të reja të diskriminimit. Po ashtu është shprehur vullneti i pjesëmarrësve që rastet t'i raportojnë në platformë.
- Më 18 nëntor 2025, u mbajt konferenca për nisjen e fushatës vetëdijesuese për Platformën përkatëse, që bëri bashkë palë institucionale, përfaqësues të shoqërisë civile, partnerë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Qëllimi i fushatës vetëdijesuese "**Raporto padrejtësinë. Ndërto barazinë**" ishte të rrisë vetëdijen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por edhe të publikut të gjerë, mbi ekzistencën, funksionin dhe rëndësinë e Platformës Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, kjo fushatë synoi të inkurajonte raportimin e rasteve të diskriminimit racor, duke promovuar Platformën si mekanizëm të qasshëm, të sigurt dhe të besueshëm për qytetarët, si dhe të përforcojë kulturën e llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- Më 16 dhe 17 dhjetor, 2025, në Prishtinë, u mbajt Samiti Rajonal për Luftimin e Diskriminimit Racor dhe Avancimin e Përfshirjes së Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Samiti mbledhi përfaqësues institucionale, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të të drejtave të njeriut dhe përfaqësues të komuniteteve nga rajoni, me qëllim të shkëmbimit të përvojave, praktikave të mira dhe qasjeve efektive në adresimin e diskriminimit racor dhe përfshirjen sociale. Gjatë dy ditëve, u diskutuan sfidat kryesore me të cilat përballen këto komunitete, u prezantuan iniciativa konkrete për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal për avancimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Në kuadër të samitit, në ditën e dytë, në mesin e disa paneleve, u mbajt edhe paneli 'Qasja institucionale ndaj raportimit të diskriminimit – Roli i Platformës Kombëtare në forcimin e llogaridhënies dhe mbrojtjes së komuniteteve', ku u diskutua në mënyrë të veçantë funksionimi dhe rëndësia e Platformës Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Panelistët theksuan se një mekanizëm raportimi i sigurt dhe i qasshëm është parakusht për ndërtimin e besimit të komuniteteve, forcimin e llogaridhënies institucionale dhe sigurimin e qasjes në drejtësi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke theksuar gjithashtu nevojën për promovim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndërinstitucional.



8. FUNKSIONIMI I MEKANIZMAVE PËR MBROJTJEN DHE LUFTIMIN E DISKRIMINIMIT PËRMES PLATFORMËS KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN/VITI 2025 – VIT I PARANDALIMIT TË DISKRIMINIMIT

Rastet e raportuara në Platformë që nga fillimi i punës së saj janë trajtuar sipas një metodologjie të punës që ndjek logjikën e institucioneve kompetente sipas LMD dhe institucioneve që përcaktohen me ligjet e veçanta. Të gjitha rastet tek institucionet janë përpunuar nga ekipi profesional i Platformës dhe janë adresuar tek Grupi Teknik, që kryesohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit.

Me rastin e raportimit, e në pajtim me rregullat e vendosura nga Grupi Teknik, Platforma ka analizuar rastet, e për secilin prej tyre ka përgatitur një raport analitik, duke dhënë rekomandime, përfshirë edhe për institucionet në të cilat duhet të adresohet rasti. Ekipi profesional i Platformës dhe Grupi Teknik fillimisht të gjitha rastet i kanë adresuar tek institucionet në të cilat ka ndodhur diskriminimi, me qëllim të parandalimit të tyre, por edhe tek institucionet tjera kompetente për luftimin e diskriminimit sipas LMD-së.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, në disa raste ka pasur efikasitet të kënaqshëm në trajtimin e rasteve nga disa prej institucioneve. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) mund të përmendet si shembull i tillë, sepse në mënyrë profesionale ka trajtuar rastet e adresuara nga platforma.⁶¹ Po ashtu, në rastin e diskriminimit të fëmijëve në një shkollë në komunën e Prizrenit, Platforma ka pranuar përgjigje të shpejtë, brenda 24 orëve, nga Drejtoria Komunale e Arsimit, për trajtimin e rastit dhe parandalimin e diskriminimit.⁶²

Po ashtu, edhe në rastet e diskriminimit që kanë ndodhur në Komunën e Fushë-Kosovës, ndonëse ekipi i Platformës ka ndërmarrë veprime të menjëhershme, megjithatë është vërejtur një vonesë në kthimin e

⁶¹ Rastet M.K, M.B, B.B dhe D.I.

⁶² Rast i raportuar nga N.GJ.

përgjigjeve nga Komuna e Fushë-Kosovës, si dhe përgjigjet e pranuar nuk kanë qenë adekuate dhe nuk kanë sqaruar çështjet e ngritura nga ekipi i Platformës.⁶³



Për sa i takon rasteve të raportuara tek Avokati i Popullit, edhe pse kërkesat e pranuar për trajtim, që nga muajt prill 2023 dhe vitin 2024, ekipi i Platformës dhe Grupi Teknik nuk ka marrë përgjigje në lidhje me rastet, edhe pse ka kaluar afati prej 6 muajve për hetimin e rastit, siç edhe përcaktohet në Rregulloren e punës së Avokatit të Popullit.⁶⁴ Megjithatë, në njërin nga rastet e raportuara më herët, Avokati i Popullit ka dalë me rekomandime, duke e konstatuar diskriminimin e 25 fëmijëve romë dhe ashkalinj, të cilëve i është mohuar e drejta në arsim.

Duhet të theksohet që Avokati i Popullit ka trajtuar me përkushtim të madh rastin e paraqitur nga I.S, lidhur me identifikimin nga Policia e Kosovës të etnisë së të dyshuarve në komunikatat dhe njoftimet publike.

Ndërkaq, në shembullin e procedurave të trajtimit të rasteve nga gjykatat, ndonëse është obligim ligjor sipas LMD-së, neni 16.9, që këto raste të trajtohen me prioritet, nuk ka ndodhur një gjë e tillë.⁶⁵

Në trajtimin e diskriminimit që ka ndodhur në Komunën e Fushë-Kosovës, Inspektorati i Arsimit ka kthyer përgjigje brenda ditës, duke njoftuar Platformën për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me rastin, si dhe ka dalë me raport dhe rekomandime në lidhje me rastin e raportuar.⁶⁶ Në bazë të statusit të rasteve, e në kuptimin e trajtimit të tyre, përveç rasteve të mbyllura dhe të përfunduara nga vetë Platforma ose të përfunduara me vendim të Institucioneve, ka edhe raste që janë raportuara si anonime, ose janë në procedurë të trajtimit nga institucionet.

Duhet të nënvizohet edhe bashkëpunimi i konsiderueshëm i Platformës me Avokatin e Popullit, Gjykatën Themelore në Prizren, Qendrat për Punë Sociale, Policinë e Kosovës, e mes palësh tjera, edhe me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, në drejtim të ngritjes së efikasitetit në trajtimin e rasteve të raportuara në Platformë, sidomos gjatë vitit 2024.

Në aspektin e adresimit të rasteve, Inspektorati i Arsimit mund të karakterizohet me dy aspekte kryesore:

1. E para, parandalim efikas i diskriminimit, ku secili institucion apo palë e përfshirë ndërmer veprime parandaluese⁶⁷;
2. E dyta, komunikim i vazhdueshëm me palët raportuese dhe sqarim i çështjeve të raportuara, me qëllim të adresimit të rasteve.

Tabela e mëposhtme pasqyron gjendjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në menaxhimin e rasteve të raportuara në Platformë për 3.5 vite të punës së saj, respektivisht deri **më 31 dhjetor 2025**.

⁶³ Rast i raportuar nga E.G., si dhe rasti ku e diskriminuar është E.K.

⁶⁴ Rastet e platformës të dorëzuara në Institucionin e Avokatit të Popullit, të regjistruara me numër 331/2023 dhe 332/2023, por edhe raste të tjera.

⁶⁵ Raport i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 05/159, të datës 13.09.2023, f. 13.

⁶⁶ Rasti E.K, raportuar nga E.G., është duke u trajtuar me prioritet nga Inspektorati i Arsimit, sipas përgjigjeve të pranuar nga sekretariati i grupit teknik/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit.

⁶⁷ Në të gjitha rastet e raportuara, aty ku është identifikuar diskriminimi, Platforma ka marrë përgjigje dhe informatë kthyesë nga institucionet publike dhe ato private, përgjigjet kanë qenë në funksion të marrjes së masave me qëllim të parandalimit të diskriminimit.



Rastet e Platformës sipas institucionit dhe statusit procedural të trajtimit të rastit në periudhën qershor 2022- 31 dhjetor 2025

Institucioni që trajton rastin	Numri	Procedura/statusi i rastit në trajtim
Avokati i Popullit	1	I trajtuar me raport <i>ex-officio</i> 18.11.2023 ⁶⁸
Avokati i Popullit	1	Nuk ka raport ose rekomandim
Avokati i Popullit	1	Raport në rastin nr. 637/2023, datë 28.05.2024
Avokati i Popullit	1	Ka dhënë përgjigje për adresim
Avokati i Popullit	1	E ka regjistruar rastin në muajin shtator 2025
Avokati i Popullit dhe Inspektorati i Arsimit	1	Ka veprim nga Inspektorati i Arsimit lidhur me diskriminimin në arsim në komunën e Fushë-Kosovës
Gjykata Themelore në Prizren	1	Aktgjykimi C.nr. 1791/2023, datë 02.08.2024
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Nuk ka ende vendim të shkallës së parë
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Është vërtetuar diskriminimi indirekt me aktgjykim të gjykatës
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Një rast është në trajtim e sipër në procedurë civile, e që ka të bëjë me dëmin e shkaktuar ndaj pjesëtarëve të komunitetit rom
Inspektorati i Arsimit dhe Avokati i Popullit	1	Është trajtuar me rekomandim nga Inspektorati
Komuna Prizren/Drejtorja e Arsimit	1	Rast i përfunduar/parandalim i diskriminimit.
Komuna Istog/Rasti në arsim dhe uzurpim i pronës	2	Ka adresuar rastet me përgjigje dhe masa të ndërmarra për parandalim. Fëmijët janë kthyer në shkollë.
Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia e regjistrimit civil	4	Të përfunduara/nuk ka diskriminim.
Policia e Kosovës	3	Raste të adresuara në 2025, veprime të ndërmarra dhe parandalim i diskriminimit dhe pasojave negative. Intervistim i palëve të përfshira në diskriminim
Policia e Kosovës/Prishtinë	2	Të adresuara nga Platforma me 2024
Prokurori i shtetit	1	Në trajtim të kallëzimit penal për gjuhën e urrejtjes
Prokurori i Shtetit	4	Raste të Adresuara nga Prokuroria Themelore në Gjakovë dhe në Prizren.
Universiteti i Gjakovës	1	I trajtuar nga Universiteti.
Agjencia e Statistikave të Kosovës	1	Me përgjigje zyrtare/i adresuar
Raste të adresuara si martesë të hershme	5	Janë pranuar përgjigjet kthyesë nga institucionet, Policia dhe QPS
Raste në pritje të trajtimit nga Platforma	2	Pritet ndërmarrja e veprimeve ligjore tek organet kompetente, në procedurë penale
Raste të tjera që nuk kanë rezultuar me diskriminim	27	<ul style="list-style-type: none"> Rastet e tilla janë regjistruar, por: 1 - nuk kanë rezultuar me diskriminim; 2 - janë anonime, si dhe 3 - nuk ka informacione Rastet vetëm janë regjistruar dhe nuk kanë rezultuar si diskriminuese, për shkak të mungesës së informacionit të raportuar në platformë, sipas sqarimeve të dhëna në raport
Rast i regjistruar për të cilin platforma nuk është kompetent.	1	Raportuesi nuk i përkiste komuniteteve rom, ashkali ose egjiptian
Rasti i gjuhës së urrejtjes	1	Pas reagimit të Platformës, pala ka kërkuar falje dhe ka tërhequr shprehjen fyese
Raste të raportuara dhe të adresuara nga të gjitha institucionet	3	Këto raste janë adresuar me përgjigje konkrete nga institucionet përkatëse.
69 RASTE		

⁶⁸ Një rast i ngjashëm është trajtuar edhe nga Platforma, i njëjti është paraqitur tek Avokati i Popullit.

■ 9. RASTET E TRAJTUARA NGA INSTITUCIONET – STORIE SUKSESI PËR VITIN 2025

Nga të gjitha rastet e trajtuara në vitin 2025, në vazhdim do të veçohen dy raste të cilat mund të konsiderohen tregime të suksesit, e që kanë të bëjnë me vërtetimin, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit. Rastet janë si vijon:

1. Rasti i sulmit dhe diskriminimit i shoqëruar me vepër penale dhe reagimi i shpejtë i prokurorit të shtetit;
2. Rasti i diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në arsim i parandaluar me sukses;
3. Rasti i diskriminimit në sektorin shëndetësor privat - rast që tregon vetëdijesim të sektorit privat ndaj diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

9.1. Rasti i sulmit dhe diskriminimit, shoqëruar edhe me vepër penale, si dhe reagimi i shpejtë i prokurorit të shtetit

Rasti është raportuar në Platformë në muajin qershor 2025, si dhe ka të bëjë me sulmin fizik ndaj një pjesëtari (të riu) të komunitetit rom në Prizren. Rasti është raportuar nga një aktivist i shoqërisë civile në komunën e Prizrenit. Ekipi profesional i Platformës ka trajtuar rastin dhe ka paraqitur raport profesional, e po ashtu është takuar edhe me raportuesin. Pas hartimit të raportit profesional, në emër të Platformës dhe Grupit Teknik i është dërguar një letër Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, e cila ka marrë përgjigje brenda 24 orëve.

Ky rast karakterizohet me: 1. Reagim të shpejtë të ekipit të Platformës; 2. Reagim të shpejtë të Prokurorit të Shtetit, si dhe procedim i rastit dhe personave të përfshirë ne vepër penale, me bazë etnike.

9.2. Rasti i diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në arsim, i parandaluar me sukses

Rasti ka ndodhur në komunën e Istogut dhe është raportuar nga një aktiviste e shoqërisë civile dhe mediave. Diskriminimi ka pasur për shënjestër komunitetin egjiptian në këtë komunë, si dhe ka pasur të bëjë me bullizim të fëmijëve në një shkollë publike në këtë komunë. Në rastin konkret, bëhet fjalë për bullizimin e pesë (5) fëmijëve të një familjeje, ku edhe dyshohet që ky bullizim ka ardhur si pasojë e prejardhjes etnike të nxënësve. Bullizimi i vazhdueshëm kishte çuar edhe tek një incident, ku sipas raportueses ka qenë i përfshirë edhe një mësimitdhënës. Si rezultat i kësaj, fëmijët ishin larguar nga shkolla. Rasti është adresuar nga Platforma, ndërsa ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar me Drejtorinë e Arsimit në komunën e Istogut, si dhe me Kryetarin e Komunës. Po ashtu, është lajmëruar edhe Zyra për çështje të komuniteteve në këtë komunë. Në një afat prej pesë (5) ditësh pas adresimit të rastit nga Grupi Teknik, rasti ishte adresuar nga Kryetari i komunës dhe fëmijët ishin kthyer në shkollë.



Ky rast karakterizohet me parandalim të bullizimit dhe të diskriminimit në arsim, me përgjigje të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Komunës së Istogut dhe kthim të fëmijëve në shkollë.

9.3. Rasti i diskriminimit në sektorin shëndetësor privat - rast që tregon vetëdijesim të sektorit privat ndaj diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ankuesi është qytetar nga Prizreni dhe pjesëtar i komunitetit rom, me kualifikim nga fusha e mjekësisë. I njëjti kishte punuar në një institucion shëndetësor privat për më shumë se dhjetë (10) ditë në periudhë provuese. Sipas provave të siguruara nga ekipi profesional i Platformës kombëtare, ankuesi kishte kryer të gjitha detyrat profesionale të caktuara nga institucioni gjatë periudhës së punës. Në momentin kur i angazhuari priste që të njëjtit t'i ofrohet kontrata e punësimit, ai ishte lajmëruar befasisht dhe në mënyrë arbitrare për mos-vazhdim, respektivisht i ishte kërkuar që të largohet nga puna dhe institucioni, pa i dhënë ndonjë arsyetim. Në bazë të bisedës së tij, ai kishte dyshime që kjo kishte ndodhur për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe ngjyrës së lëkurës. Rasti është trajtuar nga ekipi profesional i Platformës kombëtare, duke mbajtur edhe takime me ankuesin. Ekipi profesional i Platformës ka kontaktuar me institucionin privat shëndetësor dhe ka marrë arsyetimin dhe sqarimin nga ky institucion, përfaqësuesit e të cilit janë distancuar nga veprimet diskriminuese dhe kanë shprehur mbështetjen për punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ky rast karakterizohet me reagim dhe adresim nga sektori privat shëndetësor, për rastin e diskriminimit të një pjesëtari të komunitetit rom në Prizren. Po ashtu ky rast personifikon më së miri vetëdijesimin e sektorit privat në raport me Platformën dhe rastet që adresohen nga ajo.

10. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ka trajtuar me sukses 69 raste të diskriminimit brenda 3.5 viteve të funksionimit. Këto raste përfshijnë forma të ndryshme të diskriminimit, individual e kolektiv, në pajtim me ligjin ekzistues për mbrojtjen nga diskriminimi. Platforma, e menaxhuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, përbëhet nga një ekip profesional i përkushtuar për trajtimin e këtyre rasteve. Secili rast i raportuar është analizuar tërësisht, si dhe për secilin rast janë vendosur kontakte me institucionet përkatëse që janë pretenduar të jenë përfshirë në diskriminim. Pas analizës ligjore, rastet zakonisht i janë përcjellë institucioneve përgjegjëse për veprime të mëtejshme.

Ka qenë i dukshëm progresi i vazhdueshëm që ka arritur Platforma në numrin e raportimit të rasteve, përfshirë edhe trajtimin e tyre. Kjo mund të shihet edhe me faktin se që në qershor të vitit 2023, në Platformë numri i rasteve të raportuara ka qenë 23, kurse për 5 muaj, deri në nëntor të vitit 2023, ky numër u rrit në 39, që nënkupton për 16 raste më shumë, kurse në 2024, 13 raste, me vetëm një rast anonim. Po ashtu në vitin 2025, 17 raste me vetëm një rast anonim.

Është qenësore të theksohet se trajtimi i rasteve të diskriminimit përmes platformës dhe referimi i tyre tek institucionet përkatëse ndjek një procedurë hetimore që kërkon kohë. Pavarësisht kësaj, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian inkurajohen të vazhdojnë të raportojnë çdo formë diskriminimi, pasi Platforma përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm dhe plotësues, i cili i mbështet ata në mënyrë të vazhdueshme në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në luftën kundër diskriminimit.

Pavarësisht përpjekjeve dhe angazhimit të bërë nga ekipi në Platformë, Grupi Teknik dhe palët përkatëse, numri i rasteve anonime që raportohen dhe për të cilat nuk dorëzohen prova ka mbetur në nivel të njëjtë. Deri më 1 nëntor 2023, janë regjistruar gjithsej 17 raste anonime, duke treguar një vazhdimësi të trendit të mëparshëm. Megjithatë, ka pasur përmirësim të dukshëm në vitet e fundit: në vitin 2024 u raportua vetëm një rast anonim, ndërsa situata mbeti e njëjtë në vitin 2025, me vetëm një rast të regjistruar. Ky zhvillim tregon një rritje të besimit të raportuesve që nuk hezitojnë të identifikohen, gjë që është tregues pozitiv i efektivitetit dhe besueshmërisë së Platformës..

Krahas raportimeve dhe trajtimit të rasteve deri me 15 nëntor 2023, duhet theksuar që përgjatë vitit 2024, numri i rasteve të trajtuara me sukses është rritur mbi 100%, respektivisht në 18 raste gjithsej, nga 7 sa ishin deri më 15 nëntor 2023. Efikasiteti i trajtimit me sukses të rasteve në vitin 2024 ka qenë dukshëm më i madh. Ky efikasitet është rritur me një përqindje të lartë në vitin 2015, me 33 raste të adresuara, respektivisht 16 brenda vitit 2025, të cilat mund të cilësohen si raste që kanë rezultuar me parandalim të diskriminimit.

Për dallim nga raportimi i fundit në vitin 2023, numri i vizitorëve në Platformë, për vitin 2024 është shtuar për 6600 klikime, numri i llogarive aktive është rritur për 199 të tilla, që tregon frekuentim të madh të këtij mekanizmi. Në total, janë 908 llogari të hapura dhe aktive. Vetëm gjatë vitit 2025, në Platformë janë hapur 36 llogari dhe janë raportuar 17 raste, si dhe janë qasur 1535 vizitorë.

Prej të gjitha rasteve të raportuara, është evidente që dy raste të trajtuara nga platforma kanë përfunduar me aktgjykim për vërtetimin e diskriminimit. Po ashtu, gjatë vitit 2025, 16 raste në Platformë janë adresuar, duke shënuar sukses prej 100% në adresimin e rasteve dhe parandalimin e diskriminimit. Kjo po ashtu përbën sukses të Grupit Teknik, Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe vetë Platformës, për shkak se në praktikën gjyqësore të rralla janë rastet që përfundojnë me aktgjykim i cili vërteton diskriminimin.

Një fokus i rëndësishëm në përfundimet e këtij raporti duhet të jetë vlerësimi i avancimeve teknike të Platformës. Partnerët mbështetës të ZQM/ZKM në vazhdimësi kanë investuar në avancimin e platformës. Ndër avancimet teknike të cilat duhet të theksohen janë:

- Rritja e efikasitetit: Njoftimet automatike dhe proceset e thjeshtuara lehtësojnë reagimin dhe reduktojnë ngarkesën administrative.
- Përmirësim i përvojës së përdoruesve: Ndërfaqja e ridizajnuar dhe opsionet e zgjeruara të raportimit e bëjnë më të lehtë për përdoruesit të dorëzojnë raporte të detajuara.
- Analizë e avancuar e të dhënave: Eksportimi i të dhënave dhe gjenerimi i raporteve statistikore ofron informacione të vlefshme mbi tendencat dhe modelet e rasteve të diskriminimit, duke mbështetur vendimmarrjen dhe analizën strategjike.
- Privatësi dhe siguri e lartë: Veçoritë për komunikim të sigurt rrisin konfidencialitetin dhe besimin e përdoruesve, sidomos brenda komuniteteve të margjinalizuara.

Komunikim efikas me raportuesit: Bashkëpunimi i koordinuar me raportuesit siguron trajtim efektiv dhe adresim të suksesshëm të rasteve të diskriminimit. Duke u bazuar në atë që është theksuar më sipër, në vijim mund të japim këto rekomandime:

- 1.** Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, përkatësisht Grupi Teknik, duhet të vazhdojë me fushata vetëdijesuese që inkurajojnë raportimin e sa më shumë rasteve të diskriminimit në platformë. Pra, anëtarët e Grupit Teknik për Mbrojtje nga Diskriminimi duhet të kenë rol më aktiv, duke ndërmarrë veprime konkrete lidhur me rastet e raportuara, si dhe duke u angazhuar në aktivitete specifike që kontribuojnë në promovimin dhe forcimin e funksionimit të Platformës, ku përfshihen sesionet informuese, takimet me komunitetet, shpërndarja e materialeve edukative dhe realizimi i videove informuese, me qëllim ngritjen e vetëdijes dhe angazhimit në raportimin e rasteve të diskriminimit.
- 2.** Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit duhet të intensifikojë promovimin e Platformës Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtpërdrejt tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke arritur në lagjet dhe vendbanimet e tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin në raportimin e rasteve të diskriminimit, ashtu siç ka vepruar këtë vit, me organizimin e dy takimeve në formë të sesioneve, të cilat kanë pasur efekt të drejtpërdrejtë në raportimin e rasteve dhe identifikimin e diskriminimit.
- 3.** Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me komunat duhet të komunikojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për të marrë opinionet e tyre lidhur me përmirësimin dhe avancimin e platformës për raportimin e rasteve. Këtu duhen angazhuar qytetarët romë, ashkalinj dhe egjiptianë në procese të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre, ashtu që të ndikojnë në rritjen e besimit të këtyre institucioneve ndaj komuniteteve përkatëse, si dhe uljen e numrit të rasteve anonime të raportuara në Grupin Teknik përmes Platformës.

4. Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit duhet të vazhdojnë që përmes Platformës të monitorojnë rastet në proces deri në përfundimin dhe trajtimin e tyre të mirëfilltë nga ana e institucioneve kompetente.
5. ZQM/ZKM duhet të ndërmarrë hapa avokues që të mundësohet qasja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve të mësimin plotësues dhe alternativ, në përputhje me nevojat specifike të nxënësve. Institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal duhet të ndërmarrin masa konkrete për të adresuar barrierat strukturore në arsim, përfshirë mungesën e mbështetjes akademike, vështirësitë gjuhësore dhe rrezikun e braktisjes së shkollimit. Si rast konkret, theksohet nevoja për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i Avokatit të Popullit Nr. 637/2023, i cili identifikon mangësi në ofrimin e mësimin plotësues dhe alternativ për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë-Kosovës, duke shërbyer si shembull për ndërhyrje institucionale që duhet të trajtohen në mënyrë sistematike edhe në komunat e tjera.
6. Grupi Teknik duhet të intensifikojë avokimin institucional dhe publik, me qëllim që të sigurohet se të gjitha institucionet kompetente, jo vetëm Avokati i Popullit, t'i trajtojnë në mënyrë serioze, të përgjegjshme dhe pa vonesa rastet e diskriminimit të raportuara përmes Platformës Kombëtare.
7. Grupi Teknik të shqyrtojë mundësinë që në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, përmes Platformës dhe Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas (ANJF), t'i referojë të gjitha rastet që kanë nevojë për ndihmë juridike falas në ANJF. Ky rekomandim jepet për shkak se në shumë raste, është vërejtur që përveç trajtimit të diskriminimit, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë nevojë të gëzojnë edhe ndihmë juridike.
8. Rastet e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që ndodhen në situatë rruge duhet të trajtohen me prioritet dhe seriozitet të veçantë. Është i domosdoshëm një reagim më i fuqishëm institucional, si dhe mobilizimi i koordinuar i mekanizmave përkatës për adresimin efektiv të këtij problemi në nivelin më të lartë. Në këtë drejtim, Grupi Teknik, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, duhet të ndërmarrë veprime konkrete për mbrojtjen e fëmijëve dhe garantimin e të drejtave të tyre themelore.
9. Në rastet të cilat raportohen në platformë, kur ato nuk kanë të bëjnë me diskriminim, palët duhet udhëzohen për ndihmë juridike falas, sidomos kur vlerësohet se ka ndonjë rast në të cilin pala raportuese mund të ketë nevojë për ndihmë juridike falas. Grupi Teknik duhet të komunikojë me ANJF-në lidhur me zhvillimin e këtij aspekti.
10. Të ngritët në nivel më të lartë adresimi çështja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që nuk gëzojnë kujdes prindëror, si dhe gjenden shpesh në situata diskriminuese. Të diskutohet kjo çështje në mes të Grupit Teknik dhe palëve përkatëse, si dhe organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Si hap konkret, duhet të mbahen trajnime për punonjësit e institucioneve sociale dhe edukative mbi nevojat specifike të fëmijëve pa kujdes prindëror, duke theksuar mbrojtjen nga diskriminimi dhe nxitjen e përfshirjes së tyre.
11. Shkelja e të drejtave dhe diskriminimi nga ana e sektorit privat duhet të adresohet në mënyrë më efikase nga ana e institucioneve kompetente, duke pasur parasysh që pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian diskriminohen në masë më të madhe nga sektori privat. Kjo çështje duhet të jetë temë e diskutimit në njërin ose disa nga takimet e Grupit Teknik për vitin 2026, me qëllim të identifikimit të boshllëqeve institucionale, sqarimit të kompetencave të institucioneve përgjegjëse dhe dakordimit për masa konkrete, përfshirë reagimin më të shpejtë ndaj rasteve të raportuara, por edhe inicimin e fushatave vetëdijesuese dhe aktiviteteve specifike për sektorin privat lidhur me obligimet ligjore për mos-diskriminim.



- 12.** Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe Grupi Teknik duhet të vazhdojnë të trajtojnë e të adresojnë të gjitha rastet e raportuara në Platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Gjithashtu, duhet të organizohen aktivitete për ngritjen e kapaciteteve profesionale të anëtarëve të këtij grupi, me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të diskriminimit që nga pranimi i tyre në Platformë e deri te referimi i strukturuar tek institucionet kompetente, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi. Ky zhvillim kapacitetesh është thelbësor për të siguruar funksionimin efektiv dhe të pavarur të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, duke garantuar vazhdimësinë institucionale.
- 13.** Grupi Teknik duhet që në periudha të caktuara e të përsëritura t'i drejtohet me shkresa e kërkesa të gjitha institucioneve që kanë kompetenca për zbatimin e LMD-së, më qëllim të freskimit të informatave mbi punën e Platformës, si dhe të kërkojë nga institucionet respektive që rastet që adresohen nga platforma, në këto kushte ligjore, të trajtohen me prioritet, ashtu që të ndalen pasojat e mundshme që mund të shkaktohen nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, gjithnjë duke ruajtur pavarësinë e institucioneve përkatëse.
- 14.** Të gjithë raportuesit e rasteve të diskriminimit rekomandohen që nëse nuk duan ta raportojnë rastin me të dhënat e tyre (emër e mbiemër), së paku të lënë vetëm një informatë kontaktuese, email apo numër telefoni, ashtu që ekipi i platformës t'i kontaktojë për të adresuar rastin e tyre në mënyrë anonime dhe duke mbrojtur të dhënat e tyre, sipas kërkesës. Ky rekomandim duhet të theksohet përmes fushatave dhe sesioneve informuese, përmes Grupit Teknik, Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, komunave dhe institucioneve tjera relevante, sipas LMD-së.
- 15.** Qeveria të sigurojë kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të garantuar qëndrueshmërinë e platformës, në mënyrë të pavarur nga mbështetja e donatorëve, duke siguruar funksionimin e vazhdueshëm dhe efektiv të saj.
- 16.** Inkurajohen organizatat e shoqërisë civile që të mbështesin ZQM/ZKM në raportimin e sa më shumë rasteve të diskriminimit në kuadër të Platformës, duke pasur parasysh kontaktin e tyre të vazhdueshëm që kanë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian si dhe besimin e krijuar tek këto komunitete.


Edhe pse disa nga rekomandimet përputhen me ato të raporteve të publikuara në dhjetor të vitit 2023 dhe atij në prill të vitit 2025, konsiderohet e rëndësishme që të ritheksohen të njëjtat, pasi vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme, edhe aktualisht. Vazhdimësia e këtyre rekomandimeve synon që platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe puna e Grupit Teknik për Mbrojtje nga diskriminimi të avancojë në mënyrë më të suksesshme dhe efektive.




SHTOJCA I:

PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN, PARAQITUR NË STATISTIKA


I.




II.



III.



IV.




V.

RASTET E DISKRIMINIMIT NDAJ KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN TË RAPORTUARA SIPAS VITEVE




VI.

RASTET E RAPORTUARA SIPAS KOMUNËS KU KA NDODHUR DISKRIMINIMI




VII.

RASTET E RAPORTUARA SIPAS STATUSIT TË TRAJTIMIT




VIII.

RASTET E RAPORTUARA SIPAS STATUSIT TË PERSONIT QË KA RAPORTUAR RASTIN




IX.

RASTET E RAPORTUARA NË PLATFORMË SIPAS SUBJEKTIT NDAJ TË CILAVE ZBATOHET LIGJI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI (NENI 2.1)



X.

**RASTET E RAPORTUARA NË PLATFORMË SIPAS AUTORITETIT
PUBLIK TË PËRFSHIRË NË DISKRIMINIM**






SHTOJCA II:

PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN, PARAQITUR NË STATISTIKA PËR VITIN 2025

I.




II.




III.

RASTET E RAPORTUARA SIPAS GJINISË SË PERSONAVE TË DISKRIMINUAR




IV.


RASTET SIPAS STATUSIT TË TRAJTIMIT




V.




VI.



VII.



VIII.





VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO



Terre des hommes
Ndihmë për fëmijët.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**